



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 25.02.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i projektligjit “Për nxitjen e punësimit”.
2. Shqyrtimi i projektligjit “Për censusin e popullsisë dhe të banesave”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Hyseni, Edmond Leka, Spartak Braho, Jurgis Çyrbja, Elena Xhina, Edlira Bode dhe Xhemal Qefalia

Mungojnë:

Enkelejd Alibeaj, Klotilda Bushka, Damian Gjikhuri, Alket Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Dhurata Çupi, Astrit Veliaj, Fatmir Mediu, Nasip Naço ,Silva Caka dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Dajna Sorensen - Zëvendësministre e Financave dhe Ekonomisë

Silva Banushi – Drejtoreshë Drejtorie në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Genta Prodani - Përgjegjëse sektori në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Joniada Zaimaj - Specialiste në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme, meqenëse plotësohet kuorumi.

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje: shqyrtimin e projektligjit “Për nxitjen e punësimit”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relatore e këtij projektligji është kolegja Elena Xhina.

Si pikë të dytë të rendit të kemi shqyrtimin e projektligjit “Për censusin e popullsisë dhe të banesave”. Komisioni ynë për këtë projektligj është komision për dhënie mendimi. Relator i këtij projektligji është kolegu Alket Hyseni.

Duke qenë se Komisioni i Ekonomisë, si komision përgjegjës, na ka kërkuar që ta shtyjme shqyrtimin e këtij projektligji për një ditë tjetër, unë, me mirëkuptimin edhe të relatorit, do t’u kërkoja kolegeve të komisionit që këtë projektligj ta shtyjme në mbledhjen e radhës kur të rakordojmë edhe me Komisionin e Ekonomisë.

Atëherë, sot do të vazhdojmë vetëm me shqyrtimin e projektligjit “Për nxitjen e punësimit”.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, zonja Dajna Sorensen, zëvendësministrja; zonja Silva Banushi, drejtoreshë drejtorie; zonja Genta Prodani, përgjegjëse sektori, dhe zonja Joniada Zaimaj, specialiste.

A kanë ardhur përfaqësuesit e INSTAT-it?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Përfaqësuesit e INSTAT-it ndodhen te Komisioni i Ekonomisë. Gjithsesi, unë shpresoj që përfaqësuesit e INSTAT-it do t’i bashkohen edhe Komisionit të Ligjeve.

Pa humbur kohë, do t’ia kaloj fjalën zonjës Sorensen për të bërë një prezantim të projektligjit “Për nxitjen e punësimit” për kolegët e komisionit. Më pas fjala do të jetë për relatoren, zonjën Xhina.

Fjala është për ju.

Dajna Sorensen – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Projektligji “Për nxitjen e punësimit” u hartua me qëllim reflektimin e ndryshimeve dhe dinamikave të tregut të punës pas një periudhë 23-vjeçare, që nga miratimi i ligjit ekzistues i vitit 1995. Gjithashtu, projektligji u hartua edhe nën frymën e vizionit qeverisës, ku

kualifikimi profesional dhe punësimi duhet të jenë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin. Nevoja për rishikimin e politikave aktuale për nxitjen e punësimit dhe sistemit të kualifikimeve profesionale, në kuadër të përfshirjes së arsimit dhe formimit profesional, ishte e domosdoshme.

Programi i qeverisë 2017 – 2021 e ka vënë fokusin te punësimi dhe zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin dhe direktivat e Bashkimit Europian, Strategjisë Europiane të Punësimit 2020, si dhe kërkesave për integrimin europian të Shqipërisë në BE.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014 – 2020 është dokumenti primar i politikave të punësimit dhe formimit profesional dhe e ngarkon sistemin me detyra dhe aktivitete në lidhje me qeverisjen e tregut të punës, programe aktive të tregut të punës, të arsimit dhe formimit profesional e të tjerë.

Ky projektligj ka për qëllim rritjen e punësueshmërisë së forcave të punës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve dhe programeve publike të punësimit dhe vetëpunësimit, si dhe formimit profesional. Ky projektligj përcakton objektivat dhe funksionet e sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programeve aktive dhe pasive të tregut të punës, arsimin dhe formimin profesional, si dhe institucioneve përgjegjëse për menaxhimin e tyre.

Konkretisht, krahasuar me ligjin ekzistues të vitit 1995, ky projektligj parashikon një gamë shumë më të gjerë programesh të nxitjes së punësimit, se sa janë ato të parashikuara në ligjin ekzistues, me një fokus të veçantë tek të rinjtë dhe grupet e tjera vulnerabël, të cilët janë në skajet e tregut të punës.

Programet e nxitjes së punësimit përfshijnë: programet e punëve publike, vetëpunësimin, praktikat profesionale apo trajnimin nëpërmjet punës për të cilat mbështeten, subvencionimin, në përqindje të caktuar, e kostove për sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; pagat; formimin profesional; formimin nëpërmjet punës; vetëpunësimin; mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit; pajisjen e vendit të punës dhe akomodimin e arsyeshëm; zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional; programet e mbështetjes së të diplomuarve/certifikuarve në arsimin dhe formimin profesional; praktikat profesionale; programin e garancisë rinore; programet e riintegrit social; transportin për në vendin e punës, si dhe të tjera.

Gjithashtu, në projektligj janë parashikuar forma të tjera mbështetëse për ofruesit publikë, ashtu edhe për ata privatë, për t'u mbështetur financiarisht për realizimin e kurseve dhe për punëkërkues të papunë dhe për profesione të kërkuara në tregun e punës, sipas nevojave të përcjella pranë zyrave të punës.

Në këtë projektligj është parashikuar edhe ngritja e institucionit përgjegjës për shërbimet e punësimit dhe aftësimin, që aktualisht sot është Shërbimi Kombëtar i Punësimit, e cila do të jetë një njësi dhe do të bashkërendojë dhe do të rikonceptojë, sipas praktikave më të mira, modernizimin e zyrave të punës, ofertën e arsimit dhe formimit profesional, sistemin e shërbimeve të punësimit, programet e nxitjes dhe ato të të nxënimit gjatë gjithë jetës.

Në projektligj janë rregulluar dispozita në lidhje me punësimin e personave me aftësi të kufizuara, ku që nga viti 1995 deri më sot nuk kanë gjetur zbatim në ligjin ekzistues. Përveç mbështetjes me programe të nxitjes së punësimit dhe përshtatje të arsyeshme, janë rregulluar edhe çështjet e detyrimit për të punësuar persona me aftësi të kufizuara nga punëdhënësit publikë dhe privatë.

Në projektligj është parashikuar krijimi i Fondit Social të Punësimit në formën e një fondi financiar publik, që administrohet nga Bordi i Administrimit të Fondit. Burimi i financimit të fondit do të jenë kontributet e punëdhënësve, të cilët nuk punësojnë një person me aftësi të kufizuara për çdo 49 persona të punësuar prej tyre. Në këtë rast ata do të jenë të detyruar të derdhin një kontribut në llogari të këtij fondi çdo muaj për çdo person me aftësi të kufizuara në masën 50% të pagës minimale në shkallë vendi. Të ardhurat e mbledhura në Fondin Social të Punësimit do të përdoren ekskluzivisht për programe, që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitim për punë, aftësimin dhe riaftësimin profesional, orientimin dhe këshillimin për punësim e këtyre personave me aftësi të kufizuara.

Një tjetër element shumë i rëndësishëm i këtij projektligji është edhe rikonceptimi i marrëdhënies me punëdhënësit. Në nenin 19 janë përcaktuar të drejtat e punëdhënësve, duke e konsideruar atë si një proces bashkëpunimi dhe jo një proces detyrimesh të njëanshme nga ana e punëdhënësve, siç është në ligjin e ekzistues. E gjithë kjo pjesë është riparë edhe në zbatim të paketës “*Doing business*”, të miratuar nga Këshilli i Ministrave, me qëllim lehtësimin e procedurave për fillimin e një biznesi të ri. Kështu, në këto nene është parashikuar se çdo punëdhënës ka të drejtë të marrë informacion për tregun e punës, legjislacionin e punës, programet shtetërore të punësimit në zyrat e punësimit e të tjerë. Gjithashtu, punëdhënësi ka të drejtë të publikojë në këtë strukturë vendet e lira të punës që disponon.

Projektligji “Për nxitjen e punësimit” u përzgjedh nga Kryeministria për t’u miratuar sipas metodologjisë së re për ngritjen e grupeve të punës për pilotimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit në disa ministri. Metodologjia e re u hartua dhe iu bashkëngjiti këtij projektligji. Gjithashtu, dua të theksoj faktin se ky projektligj ka filluar hartimin e tij që në vitin 2014 dhe është konsultuar në disa runde të ndryshme në vitin 2015 edhe sërish në vitin 2018, qofshin këto me përfaqësues të sektorit privat apo me grupe të

interesit, sikurse është miratuar pranë Shërbimit Kombëtar të Punësimit një herë në vitin 2015 dhe sërish në vitin 2018.

Në hartimin e projektligjit kanë asistuar edhe organizatat ndërkombëtare, duke përmendur këtu Organizatën Ndërkombëtare të Punës (ILO), projektin e PNUD-it dhe projektin e GIZ-it.

Për çfarëdolloj pyetjeje që mund të keni jam në dispozicionin tuaj.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Sorensen!

Fjalën e ka relatorja, kolegia Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj zëvendësministren për sqarimin dhe detajimin lidhur me qillimin e ligjit, si dhe risitë që ai sjell në funksion të përgjegjesisë së tij!

Unë kisha ngritur një sërë çështjesh për diskutim, por ato pothuajse u ezauruan gjatë sqarimeve të zëvendësministres. Unë do të doja nga zëvendësministrja vetëm një sqarim lidhur me projektligjin.

Projektligji, në krahasim me ligjin aktual, bën një parashikim të ndryshëm për sa u takon masave për zgjidhjen e punësimit për personat me aftësi të kufizuara, duke parashikuar detyrimin për punësimin të një personi me aftësi të kufizuar për çdo 50 punonjës krahasuar me ligjin aktual, kur punëdhënësi kishte detyrimin e punësimit për çdo 25 punonjës. Pra, vëmë re se kemi një reduktim të numrit të punësimit të personave me aftësi të kufizuara. Lidhur me këtë parashikim e vlerësoj të nevojshme që të na argumentoni kriteret që janë marrë në konsideratë për caktimin e këtij raporti. A janë mbajtur në konsideratë rekomandimet e standardeve ndërkombëtare në rastin konkret? Cilat janë efektet e pritshme nga ndryshimi i këtij raporti, që ju keni propozuar në rritjen e mundësisë së punësimit të kësaj kategorie vulnerabël?

Mendoj që të marrim përgjigjet e këtyre pyetjeve dhe më pas të diskutojmë përsëri.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zonja Sorensen.

Dajna Sorensen – Një nga pikat më të nxehta të diskutimit në vazhdimësi dhe të konsultimit të këtij projektligji ka qenë pikërisht ky kriter. Unë dua të nënvizoj faktin se në ligjin e vitit 1995 parashikimi ka qenë që një person me aftësi të kufizuara duhet të punësohet për çdo 24 të papunë, por ky detyrim ligjor, që nga viti 1995 deri më sot, nuk është zbatuar asnjëherë.

Një element shumë i rëndësishëm është evoluimi i zhvillimit të sektorit privat. Sektori privat në vitin 1995, kur u hartua ai projektligj, ka qenë në një tjetër stad zhvillimi se sektori privat, që është sot. Numri i ndërmarrjeve që kishin mbi 25 punonjës në atë periudhë ka qenë

shumë më i vogël se sa numri i ndërmarrjeve që është sot, të cilat kanë më shumë se 25 punonjës. Deri diku është bërë ky reflektim i ndryshimeve në tregun e punës.

Një element tjetër shumë i rëndësishëm është se jemi bazuar në praktikat ndërkombëtare. Ka shumë vende të BE-së ku qasja po zhvendoset nga politikat që vendosin penalitete për ndërmarrjet, në drejtim të politikave incentivuese që sektori privat të punësojë persona me aftësi të kufizuara. Edhe në vendet e Bashkimit Europian, mund të përmend Spanjën dhe Luksemburgun, kanë të njëjtin kriter 1 në 50 punëtorë. Për shembull, një ndërmarrje që ka 1000 punëtorë, me ligjin e vitit 1995 duhet të punësojë 40 persona me aftësi të kufizuara, që realisht mund të jetë një barrë shumë e madhe. Por në momentin që ata nuk kanë mundësi për të punësuar kaq shumë persona, ata duhet të paguajnë një *levy*, që është goxha substanciale në momentin që bëhet krahasimi 1 për 25 të punësuar.

Elementi i fundit që unë dua të përmend, paralelisht ne kemi një punë shumë të madhe për të bërë, sepse duhet të tërheqim personat me aftësi të kufizuara që të vijnë pranë zyrës së punës.

Nëse të gjitha bizneset, institucionet publike apo ato private do të punësonin sipas kriterit 1 në 50, ne do të kishim mbi 6000 veta të punësuar sot. Numri i personave me aftësi të kufizuar, të regjistruar pranë zyrave të punës, aktualisht është rreth 500, të cilët janë të gatshëm për t'u integruar në tregun e punës dhe janë duke kërkuar punë.

Me rritjen e ndërgjegjësimit edhe numri i personave me aftësi të kufizuar që mund të integrohen në tregun e punës do të jetë në rritje.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Xhina.

Elena Xhina – Faleminderit për shpjegimin!

Zoti kryetar, së bashku me këshilltarët e komisionit kemi sugjeruar disa ndryshime të dispozitave apo riformulime të tyre, të cilat do të përmirësojnë kuptimin dhe objektivin e ligjit, do të dalin më në pah risitë që ky ligj do të sjellë, gjithashtu do të përmirësojnë kuadrin e teknikës legislative dhe fushës së përgjegjësive së komisionit tonë.

Meqenëse ligji kalon për herë të parë në komision, u sugjeroj deputetëve ta miratojmë në parim dhe gjatë diskutimit nen për nen mund të flasim për këto dispozita që janë përmirësuar dhe përditësuar.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

A ka pyetje nga kolegët?

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Sorensen!

Unë dua t'ju përgëzoj për sjelljen e ligjit të ri, i cili shfuqizon ligjin e të vitit 1995, kur Shqipëria nuk ka pasur Kushtetutë dhe kur marrëdhëniet e punës dhe politikat e punësimit sot janë të ndryshme.

E dyta, një vlerësim i veçantë është edhe për raportin e vlerësimit të ndikimit. Është hera e parë që në Kuvendin e Shqipërisë vjen një raport vlerësimi të ndikimit të ligjit me detaje, si dhe me tabelat e konsultimit publik, për këtë dua t'ju përgëzoj.

E kam lexuar projektligjin me vëmendje dhe, meqenëse jemi komision që shikojmë përputhshmërinë me Kushtetutën dhe me ligjet e tjera, kam disa pyetje në raport me Kodin e Punës.

E para, projektligji adreson një sërë problematikash që lidhen me tregun e punës, me ofertën e aftësisë, me formimin profesional e të tjerë dhe synon të sjellë një organizëm të ri (të paktën nga ligji rezulton), një institucion përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Pyetja ime është: përse ky institucion përgjegjës për punësimin dhe aftësitë nuk rregullohet në këtë ligj, por lihet të rregullohet me një VKM? Ky institucion do të jetë në nivel vendor apo në nivel qendror? Cilat do të jenë kompetencat e këtij institucioni në raport me kompetencat që ka Ministria e Ekonomisë dhe e Financave dhe në raport me ato kompetenca që Kodi i Punës i jep Këshillit Kombëtar të Punësimit?

E dyta, në legjislacion ju parashikoni këshillin konsultativ trepalësh. Në nenin 200/1shikoj të Kodit të Punës, të shtuar në vitin 2015 thuhet: “Këshilli konsultativ trepalësh rajonal është i ndryshëm nga këshilli konsultativ trepalësh, që rregullon ligji”. Pyetja është: në çfarë raporti qëndron këshilli konsultativ trepalësh rajonal, që rregullon Kodi i Punës me këshillin konsultativ trepalësh dhe këshillat vendorë trepalësh, që rregullon ligji për nxitjen e punësimit?

E treta, në këtë ligj nuk shikoj, ndoshta e kam gabim, përfshirjen e sindikatave në nxitjen e informimit për të drejtat e punonjësve dhe në shumë aspekte të tjera. A jeni konsultuar me sindikatat për këtë proces dhe cili është qëndrimi i tyre? Çfarë raporti do të kenë sindikatat në zbatimin e ligjit të nxitjes së punësimit dhe mbi të gjitha për të drejtat që ju keni parashikuar në ligj, për detyrimet që kanë punëdhënësit për të informuar punëmarrësit në rastet e falimentit të biznesit?

Pyetja tjetër ka të bëjë me një institut tjetër, që parashikon Kodi i Punës, që është transferimi i ndërmarrjeve dhe e drejta e punonjësve për të marrë informacion për ruajtjen e të drejtave dhe detyrimi i punëdhënësve për t'i informuar ata. Në këtë kuadër a shikoni ndonjë

lidhje mes ligjit “Për nxitjen e punësimit” dhe detyrimit që kanë ata për informim, në rastet kur ndërmarrja transferohet, riorganizohet dhe falimenton?

Çështja tjetër që dua të theksoj lidhet me punësimin e personave me aftësi të kufizuar. Ju ndoqa me vëmendje dhe lexova me kujdes raportin e ndikimit të këtij projektligji dhe ne bëjmë një ndryshim në ligj, nga 1 në 24 që e ka pasur ligji, sot shkojmë në 1 person me aftësi të kufizuar për 49 punonjës në çdo ndërmarrje. Për këtë ju sollët si argument që ka qenë i vështirë punësimi i personave me aftësi të kufizuar, dhe unë jam dakord me konstatimin që bëni, po cilat do të jenë detyrimet që ka ky institucion përgjegjës, në nivel qendror apo vendor aty ku do të ngrihet, lidhur me punësimin e personave me aftësi të kufizuar dhe përmbushjen e këtij detyrimi që mos të jetë fiktiv, siç ka qenë që nga viti 1995 dhe në vijim?

E dyta, a mendoni që ofrimi 50 % e pagës në rast se nuk përmbushet ky detyrim do të stimulojë punëdhënësit që të punësojnë njerëz me aftësi të kufizuar? Cila është arsyeja që nuk e keni bërë një pagë të plotë minimale, me qëllim që t’i dhemb një punëdhënësi nëse ai nuk merr një person me aftësi të kufizuar?

E fundit, është përsëri për raportin me Kodin e Punës. Ne në Kodin e Punës në ndryshimet që kemi bërë në vitin 2015 kemi parashikuar nenin 149/1 ku thuhet: “Informimi për vendet e lira të punës dhe mundësitë e punësimit”, i cili është shtuar me ligjin nr.136/2015. Më rezulton që ky detyrim i parashikuar në Kod, dhe Kodi prevalon në raport me ligjin “Për nxitjen e punësimit”, nuk është i pasqyruar në ligjin “Për nxitjen e punësimit”. Kjo është një harresë? Po flas për informimin e personave me kontratë të caktuar dhe për mundësinë që duhet t’u jepet personave për trajnimin me përparësi dhe për sigurimin e vendeve të punës.

Në parim kisha këto pyetje, kur të kalojmë në diskutimin nen për nen, ruaj të drejtën për të bërë disa komente dhe sugjerime.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Sorensen, do t’ju lutesha që përgjigjet t’i jepni në mënyrë të qartë dhe të shkurtër.

Dajna Sorensen – Unë do t’u përgjigjem bashkë me Gentën disa pyetjeve.

Për sa i përket pjesës së institucionit përgjegjës për zbatimin e politikave të punësimit, institucioni përgjegjës, që në rastin konkret do të zëvendësojë Shërbimin Kombëtar të Punësimit, përmendet edhe në ligjin e kaluar “Për arsimin dhe formimin profesional”, ligji nr. 15/2017, ku flitet për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësimin. Gjatë periudhës së konsultimeve ne e kishim në mënyrë eksplicite të përmendur këtë institucion përgjegjës, Agjencinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim, por në procesin e konsultimeve me ministritë

e linjës dhe me institucione të tjera përgjegjëse, konkretisht edhe me DAP-in, na është kërkuar që ky nen të hiqej. Arsyen e shpjegon Genta.

Genta Prodani – Nga DAP-i na u sugjerua që në zbatim të ligjit nr. 90/2012 “Për organizimin e administratës shtetërore” krijimi i agjencive apo i institucioneve të formës me të cilën do të jetë AKPA, do të bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave. Pra, ligji është i qartë në lidhje me këtë institucion që ne duam të krijojmë, i cili do të dalë në zbatim të ligjit nr. 90 të vitit 2012 “Për organizimin e administratës shtetërore”.

Në ligjin “Për nxitjen e punësimit” na u sugjerua nga DAP-i që duhej të përmendej vetëm si institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë. Në projektligjin që kemi paraqitur sot bëme të gjithë rregullimin e nevojshëm, në këtë frymë që na është sugjeruar nga DAP-i.

Gjithashtu, nga DAP-i na u tha: e njëjta logjikë do të ndiqet me të gjitha ligjet e reja që do të miratohen në Kuvend në lidhje me krijimin e institucioneve përkatëse. Ne e kemi reflektuar këtë sugjerim të DAP-it.

Për sa u përket këshillave trepalësh, këshilli trepalësh i Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi do të jetë organ këshillimor dhe nuk ka lidhje me Këshillin Kombëtar të Punës. Pra, Këshilli Kombëtar i Punës është një organ këshillimor i nivelit të lartë, pasi në të marrin pjesë rreth 5 ministra dhe niveli përfaqësues nga organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve është i lartë. Në Këshillin Kombëtar të Punës diskutohen çështje të ndryshme sipas nenit 200 të Kodit të Punës, të cilat janë të lidhura me marrëdhëniet e punës, janë të lidhura me politikën e punësimit, arsimin dhe formimin profesional dhe çështje të tjera financiare të buxhetit për këto fusha që mbulohen e të tjera. Ndërsa këshilli i Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi është një këshill, i cili do të vendoset në nivel më të ulët sesa Këshilli Kombëtar i Punës, është edhe një nga sugjerimet e ILO-s që të gjitha institucionet të cilat janë të lidhura me tregun e punës të kenë një organ këshillimor tripalësh, i cili do të jetë nën nivelin e agjencive, siç e kemi aktualisht te Shërbimi Kombëtar i Punësimit. Është i njëjti këshill, i cili do të konvertohet në agjenci. Ne kemi edhe këshillat lokalë tripalësh që funksionojnë pranë zyrave të punësimit, është e njëjta logjikë edhe kjo e sugjeruar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës për ta pasur nivelin këshillimor në tripalësh në të gjitha institucionet që janë të lidhura me tregun e punës.

Dajna Sorensen – Këshilli Kombëtar Tripalësh në Shërbimin Kombëtar të Punësimit ka qenë vendimmarrës dhe në këtë rast, aktualisht kthehet në një këshill konsultativ. Ndërsa për sa u përket atyre që janë në nivel lokal dhe rajonal, misioni i tyre primar ka qenë vazhdimisht vlerësimi i dobishmërisë social -ekonomike të programeve të nxitjes së punësimit që zbatohen në nivel rajonal.

Si njihet tregu i punës në nivel rajonal? Normal, nuk njihet. Në qendër kanë një nevojë për konsultim me përfaqësues të punëdhënësve, të punëmarrësve dhe të institucionit në nivel lokal, në nivel rajonal.

Genta Prodani - Kalimi i këtij këshilli këshillimor u bë me sugjerimin e Departamentit të Administratës Publike në zbatim të ligjit nr.90/2012 që agjencia, e cila do të krijohet në atë nivel që do të krijohet, duhet patjetër që këshilli konsultativ i tij të jetë konsultativ, të mos jetë vendimmarrës.

Ulsi Manja - Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi - Ndoshta nuk kam qenë e qartë, unë ju bëra një pyetje për nenin 200/1 të Kodit të Punës, titulli është: “Këshilli Konsultativ Tripalësh Rajonal”. Më lejoni të lexoj: “Në çdo qark krijohet Këshilli Konsultativ Tripalësh Rajonal, i cili përbëhet nga përfaqësues të organizatave të punëdhënësve, sindikatat, përfaqësues të strukturave shtetërore. Këshilli shqyrton çështje me interes të përbashkët për organizatat e punëdhënësve, për organizatat sindikale që të arrijnë zgjidhje të pranueshme...”

Organizimi dhe funksionimi i këtij këshilli përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ndërkohë përbërja e këtij Këshilli Konsultativ Tripalësh është konsultativ, nuk është detyrues, është organ këshillimor për aftësim, për punësim, për të drejtat e punonjësve, i ka rregulluar Kodi i Punës. Pyetja ime është: këtë këshill konsultativ (përdoret e njëjta fjalë) tripalësh rajonal e parashikon ligji “Për nxitjen e punësimit? Nëse nuk është i njëjti, atëherë duhet të dalë qartë në objektin e tyre, sepse Kodi i Punës qëndron më lart. Po shikoj se të dy këshillat si ai i parashikuar nga Kodi i Punës, edhe ky këshill që mendohet të krijohet në bazë të këtij ligji, kanë kompetenca të njëjta në disa aspekte, ndërkohë ka edhe dallime, por që të mos kemi konflikt institucional dhe të mos kemi përplasje të këtyre dy ligjeve, duhet të qartësohet shumë mirë kuptimi i këshillit konsultativ tripalësh sipas këtij ligji.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Te neni 16 krijohej në nivel vendor. “Këshilli vendor ngrihet pranë strukturave rajonale si organ konsultativ”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në këtë kuadër dua të di: ky këshill konsultativ që ngrihet në nivel rajonal, është i njëjtë me këtë të Kodit të Punës? Nëse nuk janë të njëjtë, duhet të qartësohen shumë mirë përgjegjësitë dhe kompetencat.

Zonja Prodani nuk mora një përgjigje për institucionin përgjegjës për punësim. Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësi do të jetë në nivel vendor apo qendror? Ligji për këtë ngrihet dhe në këtë ligj duhet të përcaktohen se cili është institucioni, kompetencat,

përgjegjësitë, ku do të raportojë, përndryshe Kuvendi nuk mund të monitorojë një ligj, nëse nuk janë të përcaktuara parimet bazë të tij në ligj, në aktet nënligjore më pas rregullat e detajuara të organizimit dhe funksionimit të këtij organi përgjegjës. Të them të drejtën është hera e parë që flitet për një organ përgjegjës dhe ky organ nuk rregullohet në ligj.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Ju lutem, zonja Sorensen, kush do të përgjigjet për pyetjet e zonjës Hysi? Ndërkohë, le të dëgjojmë edhe pyetjet e zotit Fino.

Grua - Jo vetëm desha ta gjeja të cituar nenin në ligjin nr.90/2012 që na është sugjeruar nga Departamenti i Administratës Publike, që ky ligj të mos e krijojë institucionin, por thjesht ta përmendë që krijohet një institucion, agjenci ose institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësitë, pasi është ligji “Për administratën publike”, nr.90/2012 që krijon institucione që janë në varësi të ministrive. Shërbimi Kombëtar i Punësimit që është aktualisht, i cili ka një status të tillë, që është një institucion, drejtori e Përgjithshme në varësi të Ministrisë së Financave, aktualisht, do të shndërrohet në këtë agjenci për punësim dhe aftësi dhe nuk do të jetë institucion autonom, por do të jetë një institucion i varur dhe të gjitha institucionet e varësisë krijohen nga ligji nr.90/2012. Nuk ka nevojë që të krijohet me një ligj përkatës për faktin, sepse le të themi titulli i institucionit, që në rastin tonë duhet të jetë Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi, do ta marrë vetëm pas kalimit të vendimit të Këshillit të Ministrave, është ky i fundit që do të krijojë këtë agjenci në varësi të Ministrisë së Financave. Pra, nuk është niveli i një agjencie autonome, që duhet të krijohet patjetër me ligj. Kjo është shprehur edhe në ligjin nr.90/2012 ku thuhet: “Ligji ka kaluar një cikël marrjesh të mendimeve nga institucione të tjera” dhe një nga këto ishte Departamenti i Administratës Publike dhe na u sugjerua kjo gjë.

Për sa u përket këshillave konsultativë tripalësh, ajo që është krijuar, krijohet nga Kodi i Punës që është në proces, është një VKM, e cila është në proces nga Ministria e Financave, nuk janë krijuar ende. Kodi i Punës mbulon gjithçka që ka lidhje me marrëdhëniet e punës. Kodi i Punës rregullon çdo lloj marrëdhënieje, e cila është në momentin e fillimit të punës, pra marrëdhënia me sindikatat, me punëdhënësin, pas krijimit të marrëdhënieve të punës.

Për sa i përket ligjit “Për nxitjen e punësimit” gjithçka ndodh përpara se personat të punësohen. Ne kemi nevojë për të pasur një konsultim tripalësh në nivel rajonal, përpara se personat të hyjnë në punë. Nuk ka lidhje me marrëdhëniet e punës, por ka lidhje me zhvillimet e tregut të punës, me programet që zbatohen në nivel rajonal, me rekomandimet që na ka lënë Organizata Ndërkombëtare e Punës për ta krijuar në nivel rajonal për t’u konsultuar me

zhvillimet e tregut të punës. Është tripalëshe, nuk diskutohet, sepse ne duam të kemi edhe sindikatat, edhe përfaqësuesit e punëdhënësve në këtë këshill, por nuk merret me pjesën pas marrëdhënieve të punës, nuk merret me pjesën e punësimit, gjendjes i punësuar të punëmarrësve, merret me pjesën e të papunëve, atyre që janë regjistruar në zyrat e punësimit dhe si të orientohen ata më mirë në tregun e punës në zbatimin e programeve e të tjerë. Kjo është logjika që i ndan.

Ulsi Manja - Mbaroni me përgjigjet e pyetjes, sepse kanë edhe kolegët e tjerë pyetje.

Dajna Sorensen - Për sa i përket përfshirjes së sindikatave, përfaqësuesit janë të gjithë përfshirë te këshillat konsultativë, që sapo u përmendën më parë.

Për sa i përket pjesës së personave me aftësi të kufizuara dhe kriterit 1/24 dhe 1/49 më konkretisht përtej asaj që shpjegova më parë në ndryshimin në tregun e punës do të thosha se kjo pjesë e ligjit të mëparshëm nuk është zbatuar në asnjë moment, asnjëherë. Krijimi i një fondi të dedikuar që do të përdoret për aftësimin profesional të personave me aftësia të kufizuara edhe me ndërmjetësimin e tyre në punësim, krijon një mundësi unike që kjo pjesë të implementohet, të zbatohet për herë të parë.

Cili do të jetë institucioni përgjegjës për aftësimin e personave me aftësi të kufizuara? Në rastin konkret, projektligji parashikon se ajo mund të ndodhë edhe nga organizatat, përfaqësues të shoqërisë civile edhe nga ofrues privatë të shërbimeve të trajnimit profesional, nga këndvështrimi se personat me aftësi të kufizuara kanë nevojë për një trajtim që është shumë gjithëpërfshirës sesa trajtimi që sot ofrojnë zyrat e punës. Ky projektligj krijon mundësinë se nëse ka institucione të specializuara që mund ta ofrojnë shërbimin psikosocial shumë më të mirë sesa janë sot në gjendje zyrat e punës, ky shërbim mund të kontraktohet në palët e treta.

Për pyetjen, pse është ulur 50% e pagës minimale, deri diku ndaj edhe unë opinionin me ju, ndoshta nuk është incentivuese mjaftueshëm për sektorin privat dhe mund të jemi në një situatë ku ata preferojnë të paguajnë pagesën. Deri diku e kemi biseduar se jemi të gatshëm që ta rishikojmë këtë pikë.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Sorensen!

Ka pyetje të tjera nga kolegët? Nuk ka. Kalojmë te diskutimet. Kush ka diskutime? Nuk ka.

E hedhim në votim në parim këtë projektligj. Kush është dakord me projektligjin “Për nxitjen e punësimit? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zonjës Xhina, kolegëve të komisionit, por edhe përfaqësueses së Ministrisë së Financave. Do t'ju lutem në miratimin nën për nën të projektligjit të ndërhyri atje ku keni sugjerime apo riformulime konkrete!

Neni 1.

Elena Xhina – Në nenin 1 ka vetëm një riformulim të teknikës legjislative.

Ulsi Manja – A është dakord Ministria e Financave me riformulimin që propozon relatorja? Dakord.

Pra, shprehja “legjislacion specifik” të zëvendësohet me “legjislacion i posaçëm”

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 2.

Elena Xhina – Në nenin 2 kemi kërkuar të bëhet një qartësim nga komisioni që i ka rekomanduar komisionit përgjegjës, pasi neni 2 përcakton edhe qëllimin e ligjit dhe qëllimi i ligjit është rritja e punësueshmërisë së forcës së punës. Pyetja që kemi ngritur apo sugjerimi për më tepër është se forca e punës si koncept duhet të përkufizohet të përkufizimet. I sugjerojmë komisionit përgjegjës që ta përkufizojë termin “forca e punës” duke pasur parasysh rekomandimet e BB-së dhe ILO-s, pasi bëhet fjalë për moshën e personave që kërkojnë punë.

Ulsi Manja – A jeni dakord, zonja Sorensen?

Danja Sorensen – Patjetër, mund ta përfshijmë. Ne përdorim definicionin e INSTAT-it që ka për përcaktimin e forcës së punës, i bazuar në definicionin e ILO-s.

Ulsi Manja – Dakord.

Gjithsesi, në raportin që do t'i përcjellin Komisionit të Ekonomisë të bëhet ky sugjerim për nenin 2.

Neni 2, me sugjerimin e koleges.

Pro? Kundër? S’ka. Abstenim? S’ka.

Miratohet.

Neni 3. Përkufizimet.

Elena Xhina – Në nenin 3 ka disa rregullime. Në pikën 4 është një rregullim i teknikës legjislative, ku duhet të shtohet termi “në referim të Kodit të Punës”.

Në pikën 13 ka një riformulim se çfarë kuptojmë me shërbime punësimi. Në pikën 14 ka një riformulim të teknikës legjislative.

Në pikën 15 ka një riformulim të termit “përshtatje e arsyeshme”.

Në pikën 17 bëhen ndryshime në shkronjën “dh”, është një riformulim.

Bëhet një ndryshim në shkronjën “g”, ku bëhet një përshtatje me Kodin e Drejtësisë për të Mitur.

Pas pikës 17 kemi sugjeruar të shtohet pika 18, ku të jepet përkufizimi i programeve aktive të tregut, pasi shohim se ka vetëm përkufizim të programeve pasive.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam dy sugjerime:

E para, te pika 17 e nenit 3, te grupet e veçanta nuk shoh të rregulluar rastin kur personat nën moshën 18 vjeç, sidomos vajzat që kanë krijuar familje, janë me fëmijë dhe mendoj se ka nevojë për një rregullim, që të konsiderohet si një grup i disavantazhuar në tregun e punës dhe që ka nevojë të rregullohen marrëdhëniet e tyre edhe në përputhje me legjislacionin e punës.

E dyta, nga pikëpamja e teknikës legjislative do t’i sugjeronim komisionit përgjegjës që të gjitha përkufizimet t’i vendosë në rendin alfabetik.

Gjithashtu, unë kam një pyetje. Në nenin 7 ju përmendni termin “person i interesuar”. Pra, kur thuhet “shërbimet e punësimit ofrohen në tre nivele, shërbimet e informimit për punëkërkuesin, punëdhënësin dhe personin e interesuar”, nuk është e qartë se nuk ka përkufizim se cili është personi i interesuar.

Dajna Sorensen – Edhe unë, në qoftë se sot jam e punësuar, kam të drejtën të shkoj dhe të marr informacion për tregun e punës dhe shërbime, domethënë çdo njeri është i interesuar, qoftë ky i punësuar apo jo.

Vasilika Hysi – Me falni, unë këtë e kam pyetje. Jam absolutisht dakord me ju, jemi në një linjë, por mendoj se ka nevojë për një qartësim dhe t’ia lëmë komisionit përgjegjës.

Nga ana tjetër, dua të di qëndrimin tuaj lidhur me këtë grup të disavantazhuar, pra rastin kur personat nën moshën 18 vjeç janë familjarë. Ne kemi akoma martesë të hershme, nuk mund ta mohojmë. Mund të kemi një vajzë që është bërë nënë, nën moshën 18 vjeç dhe e drejta e saj për punësim në përputhje me kriteret që ka Kodi i Punës për punësimin e personave nën moshën 18 vjeç, por edhe domosdoshmërinë që të jetë një grup me një vëmendje të veçantë.

Faleminderit!

Dajna Sorensen - Jemi shumë dakord.

Vasilika Hysi - Faleminderit!

E dyta, lidhur me viktimat e mundshme të trafikimit, ne në konventë kemi detyrimin të mbrojmë jo vetëm viktimat e trafikut, por edhe viktimat e mundshme për trafikim dhe kemi te programet, te ligji i strehimit social dhe e kemi vënë në shumë pjesë të legjislacionit. A e

gjeni me vend për ta shtuar këtë si një kategori që është e disavantazhuar. Pra, ajo ka qenë viktimë, ka shpëtuar se nuk është trafikuar, ama është viktimë e mundshme.

Dajna Sorensen – E kemi konsideruar këtë pikë faktikisht, por e vetmja problematikë është se e kemi të pamundur ta identifikojmë, se si mund të jetë një viktimë e mundshme e trafikimit, sepse Shërbimi Kombëtar i Punësimit bazohet totalisht në vetdeklarim të individit që paraqitet te zyra e punës. Në qoftë se ai person nuk vetidentifikohet si i tillë, është e pamundur që një specialist i SHKP-së të bëjë këtë lloj identifikimi.

Ulsi Manja – Kam një pyetje, zonja Hysi, për shtimin te pika 17 e grupeve të veçanta të disavantazuara në tregun e punës...

(Diskutime pa mikrofon)

... mua më duket se te pika “b” thuhet “kryefamiljarë të vetëm me fëmijë në ngarkim” dhe pika “g” thotë “të rinj nën moshën 29 vjeç”. Pra, ne kemi përfshirë në grupet e veçanta gjithë të rinjtë nën moshën 29 vjeç. Pse duhet të specifikohet kjo “nënat e martuara nën 18 vjeç”. Ne kemi quajtur grup të disavantazhuar gjithë të rinjtë dhe të rejtat nën 29 vjeç.

(Diskutime pa mikrofon)

Bashkim Fino – Këtë që thatë ju kisha edhe unë, kryetar. Te grupet e veçanta, meqenëse ne i kemi përkufizuar dhe i saktësojmë, do të thotë që komisionet që do të ngrihen dhe do të punojnë me këto grupe, që quhen grupe të veçanta, nuk do të quhen grupe jo të veçanta.

Më lejoni t’ju them se në qoftë se ju keni vënë persona me moshë mbi 55 vjeç dhe është më se normale të vihen, nuk mund të vësh edhe dysheme, edhe tavan, pra të vesh edhe personat me moshë nën 29 vjeç, sepse gjithë personat nën 29 vjeç, po ta shikosh i përmbledh pika “e”, pika “ë”, pika “f” e nenit 17. Pse duhet ta vëmë “të rinjtë nën moshën 29 vjeç”? kush e ka përcaktuar se duhet të jetë mosha 29 vjeç?

Unë mendoj se kur bëjmë grupe të veçanta dhe e kam sugjerim këtë, nuk mund të vëmë edhe dysheme, edhe tavan. Jam plotësisht dakord me ata që janë mbi 55 vjeç, se kanë kushte më të vështira, janë mosha e tretë dhe duhen ndihmuar, por të bësh këtë nuk jam dakord. Në momentin që ti vë “të rinj nën moshën 29 vjeç, pothuajse i ke rrëzuar të gjitha këto të tjerat, se i fut të gjithë në një thes.

Unë them se duhet hequr “29 vjeç”. Le t’i vëmë pikat e specifikuar, sic tha zonja Hysi, që organet që punojnë ta kenë të qartë. Pse 29 e jo 25 vjeç? Ç’do të thotë kjo?

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Sorensen!

Dajna Sorensen – Ka një arsye shumë të rëndësishme te kjo pikë. Grupmosha në Shqipëri, që ka shkallën më të lartë të papunësisë, është grupmosha 15-29 vjeç . Në qoftë se ne shohim, qoftë pjesëmarrjen në forcat e punës, qoftë shkallën e papunësisë të grupmoshës 55 plus, ata kanë shkallën më të lartë të punësimit në vend. Problematika me këtë grupmoshë qëndron te papunësia e regjistruar. Në momentin që ata shkojnë te SHKP-ja, riintegrimi i tyre në tregun e punës është tmerrësisht i vështirë. Të dhënat administrative tregojnë që rreth 50% e atyre që janë pa punë të regjistruar i përkasin grupmoshës 55 plus dhe këta janë gjithashtu punëkërkues afatgjatë. Riintegrimi i tyre në tregun e punës është shumë i vështirë, ndaj ata janë identifikuar nga të dhënat administrative si një grup i veçantë.

Nga ana tjetër, papunësia rinore është thuajse trefishi i papunësisë që ka grupmosha 55 plus. Nuk ka asnjë vend, jo vetëm të rajonit, por edhe në botë, që nuk e njeh kategorinë 15-29 vjeç si kategorinë më vulnerabël në tregun e punës dhe programet duhet të jenë të identifikueshme dhe të ndryshme për këtë grupmoshë, krahasuar me grupmoshat e tjera.

Element tjetër shumë i rëndësishëm, që ne duhet të kemi parasysh është edhe mbivendosja e vulnerabiliteteve. Ti mund të jesh 15-29 vjeç dhe je vulnerabël, por, në qoftë se mbi këtë je, gjithashtu, edhe person me aftësi të kufizuara, je edhe rom, ti mund të kesh një situatë që në tërësinë tënde je shumë më tepër vulnerabël se një tjetër në grupmoshën 55 plus.

E gjithë ideja këtu ka qenë që të përfshihen të gjitha ato elementë që e bëjnë një individ vulnerabël në tregun e punës, elemente që mund të mbivendosen edhe me njëri-tjetrin.

Ulsi Manja - Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino - Faleminderit!

Me argumentin shkatërrues që tha zëvendësministrja, më lejoni që t'ju bëj një riformulim të nenit 3, pika 17!

I heqim të gjitha pikat, lëmë vetëm pikat “ç” dhe “g” dhe jemi në rregull. Pra, lëmë personat me moshë mbi 55 dhe të rinjtë nën 29 vjeç, qofshin këta romë, qofshin me aftësi të kufizuara, qofshin sakatë, quajini si të doni, por nëse ka moshën, se është me moshë, jemi në rregull. Vëmë këto dy pika, dhe këto dy pika quhen grupe të veçanta. Pra, mbi 55 dhe nën 29, dhe jemi në rregull. S’ka nevojë ta përcaktojmë jetim, se jetim është edhe ai me moshën 28 vjeç, edhe ai 56 vjeç, apo jo? Jetim quhet edhe ai. Nëse ka moshën, është në rregull. kryefamiljar është edhe ai mbi 55 vjeç, e dhe ai nën 29 vjeç. Person me aftësi të kufizuara është edhe ai mbi 55 vjeç, edhe ai nën 29 vjeç. Person i komunitetit rom egjiptian është edhe ai 28 vjeç, edhe ai mbi 55 vjeç.

Me këto argumente që jepni ju, që na bëni një ndarje poshtë 29-ës dhe mbi 55-ën, vëmë këto dy pika, i heqim të gjitha të tjerat. Edhe sugjerimi që bëri zonja Hysi është brenda këtyre dy grupmoshave që ju sapo na i thatë tani, që janë më problematike, se nuk ka punë për ta, por nuk na treguat e nga cili legjislacion e keni marrë dhe formuluar. Kështu që, unë jam plotësisht dakord me argumentin e zëvendësministres, por sugjeroj që pika 17 të ketë vetëm dy germa: germën mbi 55 vjeç dhe germën nën 29 vjeç, dhe të gjitha përfshihen brenda. Nëse ke moshën, i ke të gjitha pasta: në daç je rom, në daç je me aftësi të kufizuara...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si jo jo? Është njësoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po nga 29 deri në 55?

Bashkim Fino – Mos ma hiq fjalën, se jam duke folur.

Ulsi Manja – Pyetje ishte, pyetje.

Bashkim Fino – Sepse dua të regjistrohet kjo që po them. Gjithmonë, nga fundi ma heq fjalën, kur bëj propozime interesante. Unë jam që të vendosen këto të dyja. Në të kundërt, nuk mund të vëmë dysheme e tavan në një ligj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të vëmë dyshemenë 29, të vëmë dhe tavanin 55, dhe mbaruam. Çfarë thotë ky ligj, Çfarë thotë ky përkufizim? Të gjitha grupmoshat nga 29 vjeç deri në 55 nuk përfitojnë nga këto që quhen grupe të veçanta.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ky është thelbi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të lutem! Ky është thelbi i pikës 16, grupe të veçanta. Pra, grupmosha nga 29 deri në 55 nuk quhet grup i veçantë dhe nuk trajtohet si i tillë në raport me të tjerët. Jo se s' do të trajtohet për punë, absolutisht, por është një grup më i veçantë, që mund të përfitojë shumë më tepër dhe që duhet të përfitojë. Në këtë pikë, lëmë këto dy gjëra dhe jemi shumë në rregull. E kam propozim për komisionin përgjegjës

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Në fakt, edhe unë këtë shqetësim kam. Mes grupmoshave 29 – 55, sipas pikës 17 grupe të avantazhuara, cilat quhen grupe të avantazhuara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dajna Sorensen – Absolutisht që mund të jetë “b”-ja, kryefamiljarë të vetëm me fëmijë në ngarkim. Mund të jenë persona me aftësi të kufizuara. Të gjithë të tjerët mund të qëndrojnë.

Ulsi Manja – Dakord!

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë e ndoqa me vëmendje diskutimin e kolegut Fino, sepse pikërisht disa nga këto kategori përfshihen tek të rinjtë nën moshën 29 vjeç ose mbi 55 vjeç. Megjithatë, është e domosdoshme që këto organe të nxitjes së punësimit të kenë një fokus të veçantë në disa nga kategoritë. Këtu ka nevojë për një riformulim të nenit 17. Për shembull, nëse themi “jetim”, përfshijmë të gjithë jetimët, nga moshja e fillimit të marrëdhënieve me punën e deri sa të kenë jetën? E para kjo.

E dyta, meqenëse ka disa kategori që janë më të ndjeshme, e për të cilat kërkohen disa masa pozitive, do të thosha: një vëmendje të shtuar. Nuk po e përmend fjalën diskriminim pozitiv, se është hequr nga përdorimi. Mendoj se këto duhet të mbeten te neni 17.

Meraku që ka kryetari i komisionit, dhe ju, zoti Fino, në lidhje me moshën 29 – 55, adresohet nga të gjitha pikat e tjera, por në mënyrë të veçantë theksi vihet tek personat nga familje që përfitojnë programe të mbështetjes me të ardhura, pra me ndihmë ekonomike, punëkërkues të papunë afatgjatë, ose mund të jenë familje që dy viteve të fundit janë kthyer nga emigracioni.

Lidhur me shqetësimin që kishit ju, zonja Sorensen, për viktimat e mundshme të trafikimit, ne këtë e kemi parashikuar si kategori që përfiton edhe ndihmë juridike falas, financim. Pra, nuk ka ndonjë pengesë. Ka një dokument. Përderisa ata përfitojnë ndihmë juridike falas, përjashtim nga tarifatat dhe taksat gjyqësore, është grup i disavantazuar i mundshëm, që ka nevojë për punësim me përparësi. Kjo është e domosdoshme.

Lidhur me çështjet e tjera, kryetar, do të thosha që këtë t’ia përcjellim komisionit përgjegjës. Jo t’i heqim, por t’i saktësojmë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Zonja Xhina, si relatore

Elena Xhina – Për të saktësuar diçka, përsëri te diskutimi i zonjës Vasilika, te shkronja “h” kërkova të bëhej riformulimi, ku të themi: viktimat e trafikimit ose viktimat e mundshme të trafikimit.

Gjithashtu, pas shkronjës “h” të shtohet edhe shkronja “i”, me përmbajtjen: “Viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe viktimat e dhunës në familje”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se kjo plotëson edhe shqetësimin që ngriti zonja Vasilika.

Ulsi Manja – Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Shqetësimin që ngriti zoti Fino do t'ia rekomandojmë komisionit përgjegjës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Elena Xhina – Ne e kemi për detyrë që çdo çështje që shtrohet në këtë komision, t'ia përcjellim komisionit përgjegjës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Mund ta hedhim në votim nenin 3. Në fakt, në lidhje me nenin 3, nga relatorja ka sugjerime për pikën 4, pikën 13, pikën 14, pikën 15, pikën 17, si dhe një propozim që, pas pikës 17, të shtohet pika 18, ku të përkufizohet termi: “programe aktive të tregut të punës”.

Jeni dakord?

Atëherë, kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si dhe të gjitha propozimet e tjera, që kolegët bënë në lidhje me pikën 3, të përfshihen në raportin që do t'i shkojë komisionit përgjegjës, Kush është dakord me nenin 3, me sugjerimet e relatores dhe të kolegëve?

Pro? Kundër s'ka. 1 abstenim nga zoti Fino.

Miratohet neni 3!

Kalojmë te neni 4.

Relatorja.

Elena Xhina – Në lidhje me nenin 4, për shkak të teknikës legislative, kemi sugjeruar të bashkohet neni 1 dhe neni 2 në të njëjtin paragraf, pa ndryshuar përmbajtja dhe qëllimi i dispozitës. Në fund të pikës 3 të shtohet shprehja: “në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt” dhe kemi menduar që pika 5 është e panevojshme, pasi bën një parashikim, që në fakt parashikohet në një ligj tjetër, në rregullat e përcaktuara tek ligji për të huajt.

Ulsi Manja – Ministria e Financave.

Genta Prodan – Neni 4 i dedikohet përfituesve nga ky ligj. Për këtë arsye janë ndarë punëkërkuesit më vete dhe punëdhënësit më vete, pavarësisht se shprehja në ligj është e njëjtë. Thjesht i ndajmë si përfitues të veçantë, punëdhënësit dhe punëkërkuesit. Kjo është ideja.

Për sa i përket pikës 3, jemi dakord, kurse sa i takon pikës 5, mendoj se duhet të qëndrojmë, sepse, pavarësisht se rregullohen shërbimet e punësimit, ofrohen për të huajt, të huajt drejtohen drejt zyrës së punësimit dhe marrin shërbime. Pra, marrin leje pune e të tjera. Është një shërbim që Shërbimi i Punësimit e kryen. Faktikisht, këtu thjesht ka një referencë, që ky shërbim kryhet nga Shërbimi i Punësimit, por në bazë të ligjit për të huajt. Mendoj se mund të rrijë thjesht si një shërbim që vetë Zyra e Punësimit e kryen. Domethënë, nuk është se e rregullon si çështje, por thjesht përfitues janë edhe të huajt që marrin këtë shërbim nga Zyra e Punësimit, meqë jemi te përfituesit.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Zonja Hysi

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam pikën 3 të nenit 4. Besoj se punësimi i shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë ose të personave pa shtetësi, bëhet mbi bazën e ligjit për të huajt. Nuk shoh referimin në rregullat e përcaktuara në ligjin për të huajt.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – E lidh pika 5.

Vasilika Hysi – Ka tre ligje në Shqipëri: ligji për punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit, ligji për të huajt, si dhe ligji për azilin.

Ulsi Manja – Pika 4 i referohet ligjit për azilin.

Për Ministrinë e Financave, a e zgjidh neni 4 situatën për të cilën e keni propozuar, kështu, në variantin që e propozon relatorja, për pikën 1 dhe 2, që të bashkohen në një paragraf, pa prekur përmbajtjen, si dhe me pikën 5, që relatorja sugjeron se është e panevojshme? Ju i dhatë argumentet, që duhet të qëndrojmë kështu siç është.

A jeni dakord, që ta votojmë neni 4 me këtë formulim?

Atëherë, kush është dakord me neni 4, me riformulimin e bërë nga relatorja, duke e përfshirë pikën 5, kështu siç është?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Miratohet neni 4!

Kalojmë te neni 5.

Është kreu i dytë: “Politikat publike të punësimit”, neni 5.

Elena Xhina – Te neni 5 kam sugjeruar që pika 1 e nenit të hiqet, pasi për mendimin tim duhet të kalojmë te përkufizimet, sepse është një dispozitë, e cila në fakt përmban vetëm përkufizimin dhe nuk ka fuqi detyruese. Pastaj, në fjalinë hyrëse të pikës 2, kam propozuar që

të riformulojmë dhe përmbajtjen: “Ministria, në lidhje me politikat e punësimit, duhet të ushtrojë këto kompetenca”, duke vazhduar më pas me kompetencat që parashikon dispozita.

Duke qenë se funksioni më i rëndësishëm i një ministrie është ai politikbërës, sugjerohet që pikën 2, pas shkronjës “a” të shtohet një shkronjë tjetër, që këtu mund ta quajmë “a 1”, me përmbajtjen: “harton politika të reja për rritjen e punësimit dhe uljen e papunësisë”.

Në pikën 2, shkronja “ç” është e paqartë se çfarë do të kuptojmë me ndërhyrje në punësimin për të huajt, reformat dhe se si do të realizohet ky punësim, pasi, sikundër thamë, është një punësim që realizohet në përputhje me rregullat e përcaktuara në ligjin referues, ligji për të huajt.

Për këto arsye, ne i kemi sugjeruar komisionit përkatës, atij përgjegjës, që ta mbajë në vëmendje këtë përcaktim. Në fund të pikës 3 sugjerojmë të shtohet shprehja: “dhe strukturave rajonale vendore, në varësi të saj”.

Gjithashtu, mendojmë se komisioni përgjegjës duhet të vlerësojë mundësinë e zbatimit të politikave, në bashkëpunim dhe partneritet me punëdhënësit, për realizimin sa më të mirë dhe efikas të dispozitës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Në vijim të propozimit që bëri relatorja në nenin 5, pika 3, unë mendoj se duhet qartësuar që zbatimi i politikave publike të punësimit kryhet nëpërmjet institucionit përgjegjës, sipas rregullave të përcaktuara në këtë ligj. I rikthehem përsëri nenit 14. Neni 14 nuk thotë asnjë gjë në lidhje me institucionin përgjegjës për punësimin.

Nuk del e qartë nëse është në nivel vendor apo qendror. E thatë ju, por ligji nuk thotë gjë. Ky ligj duhet ta përcaktojë, sepse është ligj specifik. Nuk ka ligj tjetër për ta specifikuar. Duhet të përcaktohet se cili institucion është kompetenti për zbatimin e politikave publike. Është institucioni përgjegjës i parashikuar në nenin 14 të këtij ligji? Pra, të ketë një pikë referuese, sepse mund të keni përplasje kompetencash dhe do të vini përsëri ta amendoni ligjin dhe nuk do të jetë shumë larg, por shumë shpejt.

Ulsi Manja – Ministria e Financave?

Dajna Sorensen – Dakord.

Ulsi Manja – Për nenin 5 ka një sugjerim nga relatorja: pika 1 të kalojë te neni 3 “Përkufizimet”. A jeni dakord?

Dajna Sorensen – Dakord.

Ulsi Manja – Pra, biem dakord që pika 1 të kalojë si përkufizim te neni 3.

Ka sugjerime edhe për pikën 2, shkronja “ç”. Ka edhe një sugjerim të zonjës Hysi për pikën 3 për institucionin përgjegjës. Për pikën 3 ka sugjerime edhe relatorja.

Vasilika Hysi – Nëse do të pranohet propozimi që paragrafi 1 të kalojë si përkufizim, do të sugjeroj që neni 2 të riformulohet, sepse nuk mund të fillojë “në lidhje me politikën e punësimit”, por do të themi “kompetencat e ministrisë përgjegjëse janë një, dy...”. Meqenëse jemi Komision i Ligjeve, duhet ta saktësojmë këtë gjë.

Ulsi Manja – E ka riformuluar relatorja se si do të nisë neni 5. A jeni dakord me nenin 5, me sugjerimet përkatëse të bëra nga relatorja, por edhe nga kolegja Hysi? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6. Nuk ka sugjerime nga relatorja.

Elena Xhina – Nuk ka sugjerime. Vetëm të kihet parasysh përkufizimi që vendosëm te neni i përkufizimeve.

Ulsi Manja – A është dakord me nenin 6 ministria?

Dajna Sorensen – Dakord.

Ulsi Manja – Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 6.

Neni 7 “Shërbimet e punësimit”.

Elena Xhina – Në pikën 3 të nenit 7 bëhet një rregullim i teknikës legjislative, ku fjala “për ofrimin” zëvendësohet me fjalën “për të siguruar” dhe sugjerojmë që fjala “fizike” të hiqet nga terminologjia.

Në pikën 4 ne mendojmë se është një përcaktim pak evaziv se në çfarë kuadri realizohet bashkëpunimi. Nëse bëhet fjalë për kryerjen e trajnimeve, kush do t’i ofrojë? Mbase duhet të ofrohen nga organizata të akredituara për ofrimin e trajnimeve lidhur me nxitjen e punësimit.

Pas pikës 6 sugjerohet të shtohet një paragraf, sipas të cilit “kriteret që duhet të plotësojnë subjektet private për ofrimin e ndërmjetësimit dhe këshillimit profesional të përcaktohen me VKM”. Kjo bëhet duke pasur parasysh edhe nenin 19 të Kodit të Punës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kur diskutuam nenin 3 të përkufizimeve, unë diskutova në lidhje me termin “persona të interesuar”. Unë do të doja një qëndrim nga propozuesi nëse është e nevojshme ta qartësojmë “personin e interesuar”. Të kemi një përkufizim të komisioni përkatës

që të mos haset një pengesë, pra t'i thonë: nuk të ofroj shërbim informimi, sepse nuk hyn në kategoritë e personave që nuk rregullohen nga ligji.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 7, me sugjerimet e bëra nga relatorja dhe kolegja Hysi?

Dajna Sorensen – Dakord.

Ulsi Manja – Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 7.

Neni 8 “Informimi i punëkërkuesve dhe punëdhënësve”. Nuk shoh që këtë sugjerime nga relatorja.

Elena Xhina – Nuk kemi sugjerime për nenin 8.

Ulsi Manja – E votojmë nenin 8.

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Neni 8 është shumë i rëndësishëm, sepse ka të bëjë me informimin dhe në pikën 2 thuhet se informacioni ofrohet në forma dhe formate, që janë të arritshme, të kuptueshme për punëkërkuesit e papunë me aftësi të kufizuar. Ky përkufizim është i kufizuar, i limituar dhe nuk respekton të drejtat e disa kategorive të tjera. Për shembull, ku hyjnë të miturit. Ne kemi një legjislacion të posaçëm që gjuha për fëmijët duhet të jetë në përputhje me zhvillimin e tyre moshor etj.

E dyta, mund të kemi kategori që i përkasin minoritetit rom dhe egjiptian, të cilët nuk kanë gjuhë. Parimi i përgjithshëm është që informacioni ofrohet në forma e formate të arritshme e të kuptueshme për këdo, për çdo person të interesuar. Unë jo pa qëllim ju pyeta te përkufizimi. Parimi i përgjithshëm, fjalia e parë, te pika 2 e nenit 8, duhet të jetë: “Informacioni ofrohet në forma e formate të arritshme dhe të kuptueshme për çdo person të interesuar.” Një fjali e dytë mund të bëhej duke marrë parasysh personat që nuk shikojnë dhe nuk dëgjojnë, por nuk është aftësi e kufizuar të jesh minoritet, ose kur nuk ke arsimin e duhur, nuk ke kuptueshmërinë e duhur. Pra, duhet të kemi kujdes: “Të miturit, personat që nuk kanë arsimin e nevojshëm, kulturën e nevojshme, pa dashur të diskriminoj dikë...”

Bashkim Fino – Cili është sugjerimi?

Vasilika Hysi – E bëra riformulimin.

Bashkim Fino – “Informacioni ofrohet në forma dhe formate që janë të arritshme dhe të kuptueshme”.

Vasilika Hysi – Zoti Fino, këtu kam thënë vetëm për personat më aftësi të kufizuara. Ndërkohë, informacioni duhet të jetë i qartë dhe i kuptueshëm për çdo qytetar, sepse mund të kesh të bësh me kulturën, me shkollimin, me aftësinë e të kuptuarit, me të nxënit...

Ulsi Manja – E përfshin pika 1, të lutem.

Vasilika Hysi – Jo, nuk e përfshin.

Ulsi Manja – “Shërbimi përfshin informacionin për...”.

Vasilika Hysi – Jo, flasim për gjuhën dhe për formën e ofrimit. Nëse është një shtetas i huaj, a e dini që do t’ia jepni në gjuhën e huaj?

Ulsi Manja – Po, “të arritshme e të kuptueshme”.

Bashkim Fino – E ke për pikën 1, apo për pikën 2?

Vasilika Hysi – Për pikën 2.

Bashkim Fino – E ke gabim. Unë mendova se e ke për pikën 1...

Ulsi Manja – Ta mbarojë zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Pajtohem me ju nëse do të vendosej një paragraf ku të thuhet: “Informacioni i punëkërkuësve, i punëdhënësve bëhet në mënyrë të kuptueshme e të arritshme për ta”. Ky është rregull i përgjithshëm, pastaj mund të bësh përjashtime për aftësinë e kufizuar, për minoritetet, për personat që mund të kenë vështirësi në të nxënit etj. Pra, aftësi e kufizuar nuk do të thotë se nuk di gjuhën e vendit; aftësi e kufizuar nuk do të thotë që je një fëmijë që nuk kupton për shkak të moshës. Prandaj mendoj që neni 2 cenon standardet e të drejtës për informim në gjuhë të kuptueshme dhe të thjeshtë për këdo, pastaj për grupet specifike.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Absolutisht kundër, sepse ky nen ka dy pika. Pika 1 thotë: “Strukturat rajonale vendore të punësimit sigurojnë dhe ofrojnë informacion për kërkesat e ofruara në tregun e punës si për punëkërkuësit, ashtu edhe për punëmarrësit”. Shërbimi e ka këtë informacion, tregun kombëtar etj. Pra, këtu bëhet fjalë edhe për minoritetet, thua ti. Ai e merr këtë informacion.

Pika e dytë ka të bëjë me një saktësim më të fortë: “Njerëzit me aftësi të kufizuara që nuk shikojnë, që nuk dëgjojnë e marrin informacionin sipas pikës 1”, pra egjiptiani, romi, minoritari e merr...

Vasilika Hysi – Në çfarë gjuhe e merr?

Bashkim Fino – Ky me aftësi të kufizuara nuk e merr dot. Ia japim në forma dhe formate të arritshme për ta arritur këtë gjë. Më saktë se ky nen... Në qoftë se ti do të bësh një saktësim më të plotë, duhet të bëhet te pika 1, edhe për merakun që ke për minoritarët, për

romët. Meqenëse një minoritar dhe një rom, meqë përmende këta, nuk di të lexojë, si do ta marrë këtë informacion? Nëse pika 2 ka të bëjë vërtet me njerëzit me aftësi të kufizuara, unë them ta lëmë siç është neni.

Ulsi Manja – Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Unë po ngre një problem, pastaj nëse mund ta parashikojmë te paragrafi i parë apo i dytë, është çështje tjetër. Parimi bazë është që secili duhet të informohet në një gjuhë të kuptueshme; është parim kushtetues. Forma dhe formatet duhet të jenë të kuptueshme e të arritshme. Kjo nuk është vetëm për personat me aftësi të kufizuara, por janë edhe kategoritë e tjera. Mos harroni se kemi miratuar një ligj për pakicat kombëtare.

E treta, është edhe një kategori tjetër që nuk është as pakicë, as me aftësi të kufizuara, por niveli i të nxënimit, i kulturës, pra duhet të ketë një gjuhë të thjeshtë. Këtë parim duhet të ketë. Po fole me gjuhë shkencore, nuk e merr vesh personi.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ne po bëjmë një ligj, nuk po bëjmë një rregullore të mirëfilltë apo akte nënligjore. Në ligj janë të mjaftueshme kërkesat për punëkërkuarit dhe punëdhënësit. Në qoftë se duan pastaj ta detajojnë me shembujt që dha zonja Hysi, që nuk jam kundër, le ta nxjerrë një udhëzim ministri përkatës që ndjek punësimin. Në përgjithësi, ne do të vëmë pikat kryesore në ligj. Nuk mund t'i vëmë të gjitha, sepse i bie të mos bëjmë akte nënligjore.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Zonja Hysi, të lutem!

Vasilika Hysi – Një gjë kryetar: unë shoh tabelën e konsultimit publik. Për fat të mirë, shoqatat e personave me aftësi të kufizuara kanë qenë shumë aktive dhe ndihet ndikimi i tyre në ligj. Shoh që organizatat e tjera nuk kanë qenë aktive, prandaj ka një disbalancim midis të drejtave të kategorive të veçanta. Ne si ligjvënës, si Komisioni i të Drejtave të Njeriut nuk na lejohet ta bëjmë këtë gjë. Unë jam dakord me ju... Janë dy variante, i pari është që të themi: “Strukturat rajonale, vendore të punësimit sigurojnë dhe ofrojnë informacion në një gjuhë dhe format të kuptueshëm”. Varianti i dytë: meqenëse gjuha, formati dhe kuptueshmëria e tij rregullohet në pikën 2, duhet riformuluar pika 2. Ky propozimi i bëhet komisionit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E bëra një riformulim: “Informacioni ofrohet në formë dhe në format të kuptueshëm për personat e interesuar. Një kujdes i veçantë u kushtohet punëkërkuarëve me aftësi të kufizuara, pakicave ose personave, të cilët për shkak të nivelit të tyre kulturor...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Fino, unë po improvizoj, sepse po e lexoj tani.

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe ky është një sugjerim për komisionin përgjegjës. Relatorja ndau të njëjtin mendim me mua dhe ne mund të bëjmë një riformulim dhe ta saktësojmë.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit për diskutimet lidhur me nenin 8!

Unë kam një pyetje shumë të thjeshtë. Zonja Sorensen, si e marrin informacionin në zyrat tona të punësimit sot shtetasit e huaj apo personat me aftësi të kufizuara? Dua një përgjigje me mikrofon

Dajna Sorensen – Në gjuhën shqipe?

Ulsi Manja –Sepse gjuha zyrtare, sipas Kushtetutës, është gjuha shqipe. Ju lutem, të mos bëjmë shpikje për nenin 8, sepse, sipas mendimit tim, ai është i formuluar shumë saktë. E rëndësishme është që zyrat e punësimit të ofrojnë sa më shumë punë dhe nuk besoj se do të jetë shumë problem se si do të merret informacioni për punësimin.

Hedhim në votim nenin 8, sipas formulimit që ka ligji. Kush është pro?

Vasilika Hysi – E hodhët poshtë propozimin tim?

Ulsi Manja – Do t'ia bëjmë sugjerim komisionit përgjegjës të gjitha ato që ju, zonja Hysi, ngritët në diskutimin tuaj.

Kush është pro me nenin 8, me sugjerimet e koleges Hysi për komisionin përgjegjës? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Ai është komisioni, i cili në fund ka vendimmarrjen. Ajo kishte një propozim...

Ti hodhe në votim nenin 8, sipas qeverisë, të cilin e votuam. Pastaj bëri presion zonja Hysi dhe tha: “A e hodhët poshtë propozimin tim?” dhe ju thatë: “Sipas propozimeve të zonjës Hysi”. Ne votojmë dy herë për një nen? Mbani procesverbalet siç duhet. Cilin nen 8 votuam?

Ulsi Manja – Nenin 8, sipas variantit të qeverisë.

Vasilika Hysi – Unë abstenoj.

Ulsi Manja – Zonja Hysi abstenon.

Miratohet.

Neni 9. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 10. Zonja Xhina ka diçka për të shtuar.

Elena Xhina- Në nenin 10, pika 3, sugjerojmë që germat “a”, “b” dhe “c”, pas fjalës “nxënësit” të shtohet edhe fjala “studentët”, sepse janë një grup që e përfitojnë dhe janë të lidhur drejtpërdrejt me nevojën për shërbime (**mungesë dëgjimi**).

Ulsi Manja – Kush është dakord me sugjerimin e bërë për nenin 10? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 11. Relatorja ka sugjerime për nenin 11.

Elena Xhina – Në nenin 11, germa “a”, ku parashikohet subvencionim në përqindje të caktuar i kostove për sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore, kërkojmë që të kihet parasysh edhe në komisionin përgjegjës dhe të sqarohet nëse ky parashikim është i vlerësuar në raport me legjislacionin për sigurimet shoqërore dhe kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të cilat përcaktojnë në mënyrë specifike masën e kontributeve dhe mënyrën e përballimit të tyre. Pra, duam që pika 2 e nenit 11 të jetë më e qartë dhe të shihet në përputhje ligjin për sigurimet shoqërore.

Në pikën 3, në fjalinë e parë kërkojmë të bëhet një riformulim, që kolegët e kanë përpara.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Kam një pyetje për zonjën Sorensen. A parashikohet në një nga këto pika, për shembull, te germa “dh”, ku thuhet: “Mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit”, mundësia për t’u blerë mjetet e punës, veglat e punës si një mundësi për një student të sapodiplomuar, i cili do të bëjë diçka, por nuk ka mundësi, sepse nuk ka asnjë ditë punë?

Dajna Sorensen – Në rastin konkret, pikërisht këtë nënkupton “mbështetja”. Edhe në programet që ka pilotuar Shërbimi Kombëtar i Punësimit, tashmë jo me fondet e veta, por në partneritet me ndërkombëtarët, qoftë me PNUD-in, qoftë me GIZ-in, në mënyrë të vazhdueshme financimi ka ardhur gjithmonë në blerjen e pajisjeve dhe materialeve për të ngritur një biznes të caktuar. Ky është programi që synojmë edhe për ata që mbarojnë arsimin profesional.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 11, me sugjerimet e bëra nga relatorja? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 12.

Elena Xhina – Edhe në nenin 12 janë bërë disa sugjerime. Pikat 1 dhe 2 i sugjerohen komisionit përgjegjës që të vlerësohet në këndvështrim të harmonizimit me ligjin për arsimin dhe formimin profesional.

Lidhur me pikën 3, duke marrë në konsideratë se strukturat rajonale apo vendore janë institucione buxhetore, mbështetja financiare e institucioneve të formimit profesional duhet të realizohet në zbatim të rregullave të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për prokurimin publik, e cila duhet të kihet parasysh nga komisioni përgjegjës.

Ulsi Manja – A janë dakord përfaqësuesit e ministrisë? Nuk janë dakord.

Dajna Sorensen – Për sa i përket pikës 3, në lidhje me zbatimin e rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, vetë ligji për prokurimin publik nuk e përfshin këtë lloj shërbimi dhe nuk mund të mbështetemi te ky ligj. Ideja është që, edhe pas konsultimeve që kemi bërë me Këshillin e Ministrave, procedurat për këtë lloj kontraktimi të jenë jashtë shërbimit publik, por të jenë të struktura me VKM.

Ulsi Manja – Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – As unë nuk jam dakord, siç parashitroi parafolësja, për sa kohë kemi të bëjmë me procedura konkurrimi. Unë mendoj se nuk mund t'i referohemi ligjit për prokurimin publik. Kështu që unë sugjeroj ta hedhim në votim dhe ta ketë komisioni përgjegjës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja - Për nenin 12 është varianti i qeverisë, dhe një sugjerim i relatores për pikën 3. Nëse relatorja nuk tërhiqet nga sugjerimi i bërë për pikën 3, unë e hedh në votim sugjerimin e relatores, në të kundërt hedhim në votim nenin 12 sipas variantit të qeverisë.

Elena Xhina – Duke marrë në konsideratë këshillën e zotit Fino, meqenëse është ekspert në çështjet buxhetore dhe financiare, tërhiqem nga sugjerimi i bërë.

Ulsi Manja – Atëherë, kush është dakord me nenin 12, sipas variantit të qeverisë? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 13, “Pagesa e të ardhurave nga papunësia”, i cili i përket kreut IV “Programet pasive të tregut të punës”

Elena Xhina – Lidhur me nenin 13, sugjerojmë vetëm një ndryshim në titull, pasi mendojmë të jetë “Pagesa e të ardhurave nga sigurimi i papunësisë”, që i referohet ligjit nr.7701 “Për sigurimet shoqërore” dhe termi duhet të përputhet me këtë ligj.

Ulsi Manja – A jeni dakord me nenin 13, me sugjerimin e bërë?

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Titulli i nenit 13 është “Pagesa e të ardhurave nga papunësia”. Përmbajtja e nenit ka të bëjë me detyrimin që ka personi i papunë për t’u paraqitur çdo muaj në këtë strukturë. Pra, nuk bëhet fjalë për pagesën. Ndoshta ka nevojë për një riformulim dhe është mirë që ta bëjë komisioni përgjegjës. Kur thuhet: “Të paraqitet çdo muaj në këtë strukturë”, për çfarë duhet të paraqitet, për të treguar se është gjallë? Prandaj, kur thuhet: “Pagesa e të ardhurave nga papunësia”, do të thotë që duhet të bësh një lidhje midis paraqitjes çdo muaj dhe efekti që ka në përfitimin ose jo të pagesës të ardhurave nga papunësia. Titulli me përmbajtjen nuk shkojnë, sepse nuk flitet askund për pagesën, por për detyrimin që duhet të shkojë çdo një muaj në zyrën përkatëse, rajonale apo vendore, që ne nuk e dimë nëse do të jetë në nivel qarku apo bashkie.

Ulsi Manja- Paragrafi për përfitimin e të ardhurave nga papunësia çfarë lidhjeje ka këtu? Sepse aty thuhet: “Punëkërkuesit e papunë, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia”

Elena Xhina – Atëherë, i jap plotësisht të drejtë zonjës Vasilika për mendimin e saj, pasi realisht qëllimi i dispozitës është sipas titullit të tij, por nuk del te formulimi i dispozitës. Unë mendoj se është lënë përgjysmë dhe duhet të plotësohet. Këtë duhet t’ia kalojmë komisionit përgjegjës me sugjerimin për ta plotësuar sipas titullit të dispozitës.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 13, me sugjerimin që komisioni përgjegjës të bëjë formulimin e plotë në harmoni me legjislacionin përkatës në fuqi? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 14 “Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë”, i cili i përket kreut V “Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë”. Zoti Xhafaj ka pyetje lidhur me këtë nen.

Fatmir Xhafaj – Dua të bëj një pyetje. Cili është ndryshimi midis konceptit të nenit 12 dhe nenit 14 për institucionin përgjegjës për punësimin dhe aftësitë? Sepse në rastin e nenit 12, ky është një institucion ekzekutiv dhe në rastin e nenit 14 është një institucion i natyrës këshillimore me formate të ndryshme. Ju përdorni të njëjtin term apo e kam gabim?

Dajna Sorensen – Në rastin konkret është i njëjti institucion.

Fatmir Xhafaj – Këshilli konsultativ bën edhe ...

Ka një institucionin përgjegjës për punësim dhe aftësim, i cili miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave, ku janë dy këshilla konsultativë në nivel qendror dhe vendor, por në pikën 4 i keni dhënë edhe kompetencat, që janë këshilluese. Ne kemi kaluar nenin 12, i cili ka

gjithashtu të paraparë një institucion, por me kompetenca ekzekutive. Cili është ndryshimi midis këtyre të dyjave?

Ulsi Manja – Bëhet fjalë për nenin 12, “Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë zbaton programet e formimit profesional dhe ofron...”

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, me radhë!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, doja të ndërhyja, sepse ka lidhje edhe me pyetjen e zotit Xhafaj, që është një pyetje shumë e drejtë, por mendoj se ka lidhje me një tërësi problematikash, që shtrohen nga ky nen e në vijim.

Të nderuar kolegë, po i referohem Kodit të Punës dhe dua t’ju lexoj pak formulimin se si ky ligj, më i lartë në hierarkinë e akteve ka përcaktuar institucionin që merret me çështjet e punësimit, mes të cilave edhe politikat shtetërore për nxitjen e punësimit. Në pikën 3 të nenit 200, ku flitet për Këshillin Kombëtar të Punës, thuhet: “Konsultimet do të bëhen veçanërisht lidhur me përgatitjen e zbatimit të legjislacionit të punës. Ndryshimet e këtij kodi, me politikat dhe organizmat kombëtarë, kanë të bëjnë me punësimin, formimin profesional, mbrojtjen e punëmarrësve, higjienën, sigurimin teknik, prodhimin, mirëqenien, programet e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, si edhe me zbatimin e normave të Organizatës Ndërkombëtare të Punës”. E lexova këtë për të mos u zgjatur pastaj më tej se si formohet ky këshill, për të treguar se mos pa dashje (unë po e shtroj si pyetje, por për vete jam i sigurt që ne po e bëjmë këtë gabim) ne po krijojmë një strukturë paralele, duke i marrë kompetencat një strukture të përcaktuar me një akt më të lartë.

Së pari, nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe e hierarkisë së akteve mendoj se në mënyrë kategorike po bëjmë gabim, kur them ne, flas për propozuesit që e kanë shtruar gabim. Këtu merr përgjigje edhe pyetja e zotit Xhafaj, që nuk mund të funksionojnë dy emërtesa të tilla “institucion përgjegjës”. Institucion përgjegjës është ministria me strukturat e saj të varësisë direkte, ku janë zyrat e punës sot, kurse institucionet orientuese, vendimmarrëse dhe konsultative janë ato që përcakton Kodi i Punës.

Së dyti, kemi maninë të ngremë këshilla pas këshillash, po shkojmë në një shtet, ku nuk gjejmë njerëz për të ngritur këta këshilla.

Së pari, ne nuk kemi ngritur këshillat rajonale, që janë në Kodin e Punës dhe i kanë të gjitha mundësitë t’i mbulojnë këto. Kodi i Punës ka politikat kombëtare të punësimit dhe ato të nxitjes së punësimit. Këto po bëjmë sot, pra ligjin “Për nxitjen e punësimit”. Për sa kohë ai

komitet ka kompetencat, ai duhet involvuar atje. Le të bëjmë ndonjë rregullim, nëse është i nevojshëm, por ai ligj thotë “me organe të pushtetit vendor”, ju përsëri doni të fusni organet ekzekutive. Po bëni gabime, të cilat ne, si komision, nuk duhet t’i lejojmë. Prandaj, unë propozoj që e gjithë struktura, e cila lidhet me nenet 14, 15 dhe 16, të rishikohet në fokus të kësaj shtate, ku t’i referohemi atij organi që ka Kodi i Punës dhe le të saktësojmë kompetencat. Nëse keni nevojë kompetencat që janë këtu le t’i saktësojmë dhe t’ia japim atij organi. Por nuk mund të ngremë... Ai organ trepalësh është dhe trepalësh po e ngremë dhe këtu, të njëjtën mënyrë formimi ka atje, të njëjtën mënyrë formimi ka edhe këtu. Kështu që mendoj se duhet ta riformatojmë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Në vijim të asaj që tha kolegu Hyseni, jam plotësisht dakord me këtë çështje, sepse po të shikosh nenet 15 dhe 16, thuhet: “Këshilli vendimor trepalësh mbledhet brenda çdo strukture rajonale/vendore, si organ konsultativ”. Ne e kemi një gjë të tillë dhe nuk funksionon. Pyetja duhet të ishte: sa efektivitet kanë këto struktura që janë ngritur dhe nuk kanë funksionuar? Mos duhet të ngrihen këto struktura vendore në kuadrin e 61 bashkive që ka sot Shqipëria, ku është më mirë të ngrihen ashtu, se sa në rang qarku, e cila ndoshta nuk do ta japë mbase efektivitetin e duhur?

Së treti, është ajo tha zonja Hysi në diskutimin në parim, pse këto agjenci krijohen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe nuk vendosen nga ligji përkatës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pavarësisht se e ka Kodi i Punës, në momentin që ne e vendosim në ligj është më i detajuar. Pyetja që unë kam është më thelbësore. Rekrutimi i punonjësve, në qoftë se do të bëhet sipas DAP-it, si do të bëhet? Do të bëhet me DAP, apo do të bëhet me Kod Pune? Ne e kemi të ngritur me Kod Pune. Me Kod Pune këto janë agjenci ekzekutive, që drejtohen nga lart, ku në qoftë se një punonjës nuk punon saktë (kjo duhet t’ju interesoje juve si ministri), në zyrat e nxitjes së punësimit, automatikisht duhet ta shkarkosh. Automatikisht ti duhet t’i thuash se nuk je për këtë punë, as për të ulur papunësinë dhe as për të hapur vende të reja pune, që unë të komunikoj me privatin dhe të fus sa më shumë njerëz në punë. Ju dhe ne ndiejmë një vështirësi kur vjen puna në terren, që në kuadrin e DAP-it të famshëm, do një praktikë mbi 3-4 muaj që ta lëvizësh një punonjës që është i paaftë. DAP-i mund të jetë prezent në shumë struktura të tjera, por të jetë prezent në strukturën e punësimit, që ka të bëjë me jetën e qytetarëve, të cilët duhet të punësohen, mendoj se nuk duhet të jetë. Pse? Sepse vendimmarrja ekzekutive nga ministri, nga Këshilli Kombëtar nga drejtori i madh që ju keni dhe deri te

drejtori poshtë, duhet të jetë e menjëhershme për të hequr ata njerëz që janë të paaftë, që nuk bëjnë dot këtë punë. Në qoftë se vini sot me këtë ligj, mendoj se duhet rregulluar dhe nuk duam t'ia dimë ne, si parlamentarë, edhe për mendimet që ka dhënë DAP-i, jo, ne jemi kundër mendimit të DAP-it, në qoftë se ata e kanë dhënë ashtu. Ne jemi që të ngrihet ky institucion në varësinë hierarkike të ministrit, pa DAP-in. Domethënë, punësimin si instrument, pra këto drejtori, që keni ju, e ka ministria përkatëse, por ama edhe vendimmarrjen për të kërkuar llogari, për të realizuar atë çka është kryesorja, thelbi i këtij projektligji që ne bëjmë, të jetë vërtet shumë i madh.

Në këtë kuadër them se të tria këto nene, relatorja t'i rishikojë me Kodin e Punës dhe, me këto sugjerime që ne bëmë, të rregullohen të tria këto nene. Madje neni 14 mund të bashkohet nenet 15 dhe 16, dhe të formulohen për t'ia dhënë komisionit përkatës, besoj se edhe ata do të jenë me mendimin tonë, por ne jemi Komision Ligjesh dhe na takon që të mos lejojmë mbivendosje midis një kodi, që është me 3/5-at, dhe një ligji të zakonshëm, por edhe të kësaj vendimmarrjeje të fundit që thashë unë, sepse e mbajta shënim punën e DAP-it dhe punën e ligjit të 2012-ës. Zonja tha (nuk e di çfarë përfaqëson, por kjo pak rëndësi ka) "ishte orientimi i DAP-it që ne ta vendosnim kështu", apo jo, sepse kështu e dëgjova dhe e kam mbajtur shënim. Mund të jetë orientimi i DAP-it, por nuk është orientimi ynë, sepse ne jemi ligjvënës. Ashtu siç ju e keni shikuar në praktikë gjatë gjithë kësaj kohe punën e zyrave të punës, kështu e shikojmë edhe ne, që jemi deputetë në çdo zonë të caktuar dhe interesohemi për të futur në punë njerëzit që janë në nevojë (flas për privatin, sepse në shtet duhet të hysh me DAP, duhet të konkurrosh e të tjera). Ama në rastin konkret mendoj se inspektorët tuaj janë shumë të rëndësishëm, të cilët duhet të jenë më shumë aktive. Ne nuk do të presim DAP-in sa t'i shkarkojë apo t'i emërojë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Dua të dëgjoj një mendim nga ana e Ministrisë së Financave për komplet kreun, në lidhje me sugjerimet e kolegëve.

Dajna Sorensen - Dua të bëj një sqarim të vogël, është vetëm Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Kombëtar të Punësimit, që është nëpërmjet DAP-it, zyrat rajonale dhe zyrat vendore, pra 36 zyra që ka Shërbimi Kombëtar i Punësimit, punësimi i tyre bëhet sipas Kodit të Punës, nuk kanë lidhje me DAP-in. Thjesht të jemi të qartë për këtë gjë.

Gjithashtu, për sa u përket pjesës së zyrave të punës, aktualisht ne kemi 12 zyra rajonale dhe 24 zyra vendore, që jo domosdoshmërisht janë në linjë me ndarjen e re territoriale sipas 61 bashkive. Ne kemi pasur një vlerësim nga ana funksionale dhe e kemi parë se është e nevojshme që të kemi përfaqësi në të 61 bashkitë apo jo. Vlerësimi ka nxjerrë rezultatin që, me

përrjashtim të zyrës së Tiranës, që është ineficiente, sepse është shumë e madhe si zyrë dhe ka nevojë të ndahet në disa nënzyra, të gjitha zyrat janë në madhësinë e tyre optimale dhe duhen identifikuar modalitete bashkëpunimi me bashkitë, për të mundësuar ofrimin e shërbimeve edhe në ato bashki ku nuk ekziston sot Shërbimi Kombëtar i Punësimit.

Për sa i përket nenit 200 të Kodit të Punës dhe Këshillit Kombëtar të Punës dhe nenit 200/1 këshillave rajonalë, funksioni i këshillave, në rastin e ligjit aktual, është shumë më i ngushtë, është një fraksion i kësaj që parashikohet në këshillat konsultativë trepalësh rajonalë. Domethënë, ne po flasim vetëm për një element. Ndërsa këshillat konsultativë trepalësh rajonalë nuk janë ngritur ndonjëherë, këta këshilla, që janë pranë Shërbimi Kombëtar të Punësimit dhe zyrave rajonale apo vendore të punësimit, janë funksionale, kanë qenë funksionale që nga '95 dhe vazhdon të jenë funksionale edhe sot dhe kryejnë një shërbim konkret për sa u përket programeve të nxitjes së punësimit. Kështu që nuk e shikoj me vend që të hiqet diçka, që ekziston dhe që funksionon mirë.

Ulsi Manja – Urdhëroni, zonja Hysi!

Me aq sa po kuptoj, diskutimi po bëhet për komplet kreun.

Vasilika Hysi – Po.

Faleminderit, zoti kryetar!

Jo pa qëllim e bëra pyetjen në diskutimin në parim. Nga studimi i detajuar i projektligjit dhe përmbajtjes së nenit 200 të Kodit të Punës, konkretisht në paragrafët 3, 5, 6 dhe 8 shikoj se kanë një përplasje dispozitash dhe paqartësi në projektligjin që ka ardhur. Këshilli Kombëtar i Punës është një këshill i krijuar me një ligj të cilësuar. Domethënë, në paragrafin 3 të këtij ligji, te këshilli konsultativ, ku me të drejtë e ritheksoi zoti Hyseni thuhet: “Është përgjegjës për politikën dhe organizimin që kanë të bëjnë me punësimin dhe formimin profesional”. Pra, organizimet e punësimit dhe formimin profesional e ka Këshilli Kombëtar i Punës, sipas pikës 3 të nenit 200.

Gjithashtu, në pikën 6 të nenit 200 thuhet: “Këshilli i Ministrave cakton komisione të specializuara trepalëshe të përhershme në këshillim me partnerët socialë”, çka tregon se këta këshilla trepalëshe janë pikërisht për të dhënë këshillime. Pra, i cakton Këshilli i Ministrave.

Gjithashtu, në pikën 8 të nenit 200 thuhet: “Këshilli Kombëtar i Punës mund të krijojë komisione të specializuara ose grupe pune të përhershme për këshillim dhe studim të çështjeve të veçanta, me interes të përbashkët, ku hyn këshillimi, formimi profesional...” e të tjerë.

Nga ana tjetër, jo pa qëllim ju pyeta, dhe këtë do t’ia kërkoja komisionit përgjegjës, sepse nuk po marr përgjigje: institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim është institucion

qendror apo vendor? Sepse kjo nuk bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, kjo bëhet me ligj.

E dyta, cilat janë kompetencat e institucionit përgjegjës për punësim dhe aftësim? Ato duhet të jenë në ligj, pra sipas ligjit nr. 92/2012. Domethënë, nuk mund të dilni nga ligji kuadër për agjencitë autonome, ku ta di unë, të varësisë, por duhet të jenë në këtë ligj, sepse është ligj specifik.

E treta, nuk mori përgjigje as pyetja e kolegut Xhafaj. Ju thoni, ngaqë nuk jeni të qartë se çfarë doni të bëni, se institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim krijohet me vendim të Këshillit të Ministrave, nuk ka asgjë për kompetencat, ndërkohë në pikën 12 thoni, e ktheni në ekzekutiv, pra jo politikëbërës: “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim zbaton programet e formimit profesional”. Në qoftë se thoni: “zbaton programet e formimit profesional”, i bie që institucioni të jetë në nivel vendor, nuk do të jetë në nivel qendror.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Prandaj po i kthehem pyetjes për paragrafin e katërbëdhjetë: institucioni përgjegjës për punësim do të jetë qendror apo vendor? Në varësi të përgjigjes, unë kam edhe shumë pyetje të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

I bie të riformulohen nenet 12, 15, 16 e me radhë.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zonja Hysi, tani unë nuk e kuptoj ku është përplasja ndërmjet këtij kreu me nenin 200 të Kodit të Punës, sepse duhet të keni një propozim konkret.

Vasilika Hysi – E thashë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Te neni 14? Kreu V ka tri nene, nenet 14, 15 dhe 16.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Lëreni nenin 14, sepse ky nen mund të bashkohet shumë mirë me nenin 15, siç pati...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Tani, konkretisht, relatorja, nëse çmon se këto tri nene bien ndesh me nenin 200 të Kodit të Punës...

Vasilika Hysi – Edhe me nenin 200/1-shin...

Ulsi Manja – ...dhe me të gjitha parashikimet që ka Kodi i Punës mund të uleni...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di pse nuk jeni ulur deri tani, mund t'i rishikoni dhe t'i sillni në variantin e përputhshmërisë me dispozitat e Kodit të Punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mua nuk më ngelet gjë tjetër veçse këto tri dispozita, që përbëjnë kreun V të ligjit, t'i lë të hapura dhe të kaloj te kreu VI.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – Te këto tri nene duhet mbajtur parasysh...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Relatorja dhe përfaqësuesit e ministrisë duhet të mbajnë parasysh që mandati i anëtarëve është trevjeçar. Natyrshëm pyes: pse trevjeçar? Mund të jetë edhe brenda kuadrit të një qeverisjeje katërvjeçare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vendosja e afatit trevjeçar mua më duket jokorrekte. Mandat është, konsultativ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Atëherë, nuk merret...

Bashkim Fino – E dyta që kam, e dëgjova zëvendësministren, mua nuk më pëlqeu, por kjo është një çështje si e shikojmë ne në këndvështrime të ndryshme, ngaqë jam njohës i mirë i pushtetit vendor, më pëlqen që ndarja territoriale e Shqipërisë është me një ligj i cilësuar, me tre të pestat, që e kemi bërë të gjithë bashkërisht, pozitë-opozitë, dhe ajo ndarje do të jetë funksionale (është shtetërore) për të gjitha strukturat që do të vijnë më poshtë...

Sepse të ngresh institucione për 12 qarqe, të cilat janë cunuar, u janë hequr të gjitha elementet dhe ka ngelur thjesht, po e them në gjuhë popullore, kokosh i therur kot, edhe si institucione, e kupton, duke forcuar nivelin e parë të pushtetit vendor, që është bashkia, dhe nuk ka më komuna, nuk ka më 384 njësi vendore, por ka vetëm 61 bashki, ajo është niveli i parë i drejtpërdrejtë, që votohet në mënyrë maxhoritare për çdo kryetar bashkie dhe çdo këshill, pra nuk votohet gjë për nivelin e dytë. Pra, t'u japësh hapësirë 12 rajoneve dhe të thuash: kam 24 zyra punësimi dhe janë të mjaftueshme në raport me 61 të tjerat që janë, pra diferenca është rreth njëzet e ca të tjera, mua më duket jonormale, ndaj ne duhet ta vendosim në ligj.

Pastaj, nëse e ngrini ju si ministri, keni mundësi, aftësi ose njerëz për ta bërë këtë gjë, kjo është tjetër gjë. Por përsëri ju keni të drejtën t'i ngrini zyrat e punësimit në 61 bashki.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po marr shembull qarkun ku jam deputet, ke një zyrë pune në Lushnjë. Përse duhet që zyra e punësimit në Bashkinë e Lushnjës të mbulojë Bashkinë e Divjakës? Mund të jetë vërtet

një bashki më e vogël, por mund të ketë më pak punonjës, le ta bëjë ai atë, sepse ka lidhje të drejtpërdrejta me të gjithë privatët që punojnë atje, ndërkohë që kjo nuk e ka si duhet.

Nga ana tjetër, jam plotësisht dakord kur thoni se Tirana është e madhe dhe mund të ketë nënzyra të tjera, absolutisht, dakord, mund t'i bësh sipas njësisive të Bashkisë së Tiranës, pra siç i ka rajoni 1, 2, 3, 4, 5 e me radhë, sepse është kryeqytet, por bashkitë e tjera duhet të vlerësohen, pasi ne nuk e kemi bërë kopje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonjë, vendimi dhe ligji “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor” është i njëjtë si për kryetarin e Bashkisë së Dropullit, ashtu edhe për kryetarin e Bashkisë së Tiranës, atij të Korçës, të Kukësit, të Pogradecit e kështu me radhë, çka do të thotë se zyrë funksionimi punësimi duhet të ketë në çdo bashki.

Edhe ne, zoti kryetar, por edhe ju, zonja relatore, duhet të këmbëngulni që ta vini këtë. Ne bëjmë këshilla për qarqe që nuk janë ngritur dhe nuk funksionojnë, ndërkohë që nuk organizojnë zyra punësimi për çdo bashki.

Ai që është në atë bashki, qoftë kjo edhe e vogël në raport me një bashki tjetër, duhet të jetë shumë më i interesuar për punësimin, jashtëzakonisht më i interesuar, pasi nuk mund të jetë një drejtor i punësimit në një bashki të madhe, që mban edhe dy-tri bashki të tjera në krah. Të jeni e bindur se ai shikon bashkinë e madhe dhe jo të tjerat. Kjo është një gjë që ne duhet ta vendosim në ligj...

Ulsi Manja – Dakord.

Bashkim Fino – Pastaj, ju keni mundësi ta shikoni në kuadrin e rishikimit, se është çështje juaja, e shikoni, nuk e vendosim ne aq mirë sa mund të ketë një bashki e madhe, mund ta vendosim nga një ose me dy veta. Ama zyrën e punës duhet ta ketë Bashkia e Dropullit, Bashkia e Pustecit, si dhe bashkitë e tjera të vogla, të cilat ti nuk i ke marrë në konsideratë dhe nuk i ke ngritur. Këtë e kam më tepër propozim për relatoren.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit, zoti Fino!

Besoje se relatorja i mbajti shënim, po ashtu edhe këshilltarët e komisionit, sugjerimet për tre nenet e kreut V. Do t'i lëmë të hapura dhe nuk do t'i votojmë sot.

Kalojmë te neni 17.

Fjalën e ka relatorja.

Elena Xhina – Te neni 17 është bërë një riformulim lidhur me aspektin e teknikës legjislativë, pa ndryshuar përmbajtjen ose qëllimin e dispozitës.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Biem dakord me nenin 17?

(Deputetja Hysi ndërhyr pa mikrofon.)

Vasilika Hysi – Në pikën 3 të nenit 17, ku thuhet: “Institucioni përgjegjës për punësim dhe aftësim kryen hulumtime për mbledhjen e të dhënave, për numrin e të punësuarve, për kushtet”, duhet të kemi parasysh ndarjen gjinore, pasi kjo është një kërkesë në kuadër të strategjisë së barazisë gjinore dhe nxitjes, apo jo... Të dhënat duhet të jenë edhe bazuar në treguesit gjinorë, në mënyrë që të parandalojmë edhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi një strategji të posaçme për barazinë gjinore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jua u them unë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Politikat e nxitjes së punësimit duhet të favorizojnë ose duhet të shmangin hendekun ndërmjet..., për shkak të pabarazisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Bashkim Fino – Është i përgjithshëm, zonja Hysi, institucioni përgjegjës kryen hulumtime për të gjithë, nuk e bën dallimin, pra e kryen për meshkujt, nuk e kryen për femrat! Pse duhet vënë gjithmonë për barazinë gjinore?

Vasilika Hysi – Atëherë, pse kemi bërë strategji të veçantë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – E keni gabim si koncept.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Unë jam shumë dakord me ju për atë kohë sa kemi një strategji, ku thuhet se aspektet gjinore...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bashkim Fino – A e keni për këtë këtu?

Vasilika Hysi – Për të gjitha ligjet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sensibiliteti, gjuha gjinore duhet të jetë e pranishme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni!

Unë e kam sugjerim për komisionin përgjegjës. Kemi një nënkomision për Barazinë Gjinore dhe të Parandalimit, ka edhe një strategji, që e monitoron Kuvendi dhe le ta bëjnë. Ky është një sugjerim imi. Le të mbetet rekord dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Më falni, por ky nuk është rasti sikur komisioni përgjegjës është komision i një parlamenti tjetër dhe t'ia përcjellim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Hedhim në votim nenin 17, sipas variantit që ka sjellë qeveria, me sugjerimin për teknikën legjislative që bën relatorja.

Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Një votë abstenim.

Miratohet neni 17, sipas variantit të qeverisë, me sugjerimin për pikën 1.

Vazhdojmë me nenin 18 “Mbledhja e të dhënave, shpërndarja dhe bashkëpunimi me institucione të tjera”.

Fjalën e ka relatorja.

Elena Xhina – Te neni 18 ka vetëm një ndryshim tek titulli i dispozitës, si dhe sugjerohet që pika 3 të riformulohet dhe pas pikës 3 të shtohet pika 4 me këtë përmbajtje: “Ruajtja dhe përpunimi i informacionit, që shkëmbehet sipas parashikimeve të pikës 3 të këtij neni, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi “Për mbrojtjen e të dhënave personale””.

Faleminderit!

Ulsi Manja – A bien dakord përfaqësuesit e Ministrisë...?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Nuk kam gjë për këtë nen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Jemi te neni 18.

Kush ka ndonjë gjë për nenin 18? Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Në lidhje me parimet e teknikës legjislative në përgjithësi, sugjeroj të mos përmenden emërtimet e sakta të institucioneve. Për shembull, siç është sot INSTAT-i, sepse mund të ndodhë që INSTAT-i pas pesë vjetësh të emërtohet ndryshe, dhe meqenëse INSTAT-i emërtohet ndryshe, ne të fillojmë të prekim të gjitha ligjet. Prandaj unë them të vihet: “institucioni zyrtar i statistikave”, pra një formulim i përgjithshëm dhe jo vetëm këtu, por kjo teknikë duhet zbatuar në të gjitha institucionet për ta bërë ligjin më të qëndrueshëm në kohë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Përfaqësuesit e ministrisë shprehen dakord?

Dajna Sorensen – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Biem dakord me nenin 18, me sugjerimet e bëra nga relatorja dhe kolegu Hyseni?

(Deputeti Shameti ndërhyrje pa mikrofon.)

Kush është pro nenit 18? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 18.

Kalojmë te kreu VII “Bashkëpunimi me punëdhënësit”.

Fillojmë me nenin 19 të këtij kreu “Të drejtat e punëdhënësve”.

Fjalën e ka zonja Xhina.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Elena Xhina – Nuk kemi sugjerime.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Nuk ka sugjerime për nenin 19 nga relatorja.

Kush është dakord me nenin 19, sipas variantit të propozuar nga qeveria? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 20 “Detyrimi i punëdhënësve”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Te neni 20 ka një sugjerim që të riformulohet pika 1 me përmbajtjen që kanë kolegët para tyre, si dhe pika 3 të riformulohet si vijon: “Rregullat dhe procedurat për zbatimin e pikës 2 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi lidhur me nenin 20.

Vasilika Hysi – Kërkoj që neni 20 të jetë në përputhje me Kodin e Punës dhe me ndryshimet që i kemi bërë në vitin 2015, i cili nuk flet për falimentin e pritshëm, por për një term të ri, për riorganizimin e ndërmarrjeve.

Pra, duhet të jetë në përputhje me legjislacionin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Këtu duhet thënë se punëdhënësit kanë detyrimin të informojnë, në radhë të parë, punonjësit që janë në një ndërmarrje që do të riformatohet, që do të riorganizohet dhe më pas detyrimi për të informuar të tretët jashtë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, terminologjia duhet të jetë në përputhje me Kodin e Punës.

Ulsi Manja – Biem dakord me relatoren dhe sugjerimin e koleges Hysi për ta përshtatur me termat e legjislacionit në fuqi?

Dajna Sorensen – Shprehemi dakord.

Ulsi Manja – Dakord.

Kush është dakord me nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 20.

Kalojmë te neni 21 “Punësimi i personave me aftësi të kufizuar”.

Po, zonja Xhina.

Elena Xhina – Në pikën 4 të këtij neni konstatojmë se nuk shprehet qartë qëllimi dhe mënyra e zbatimit të tij në praktikë.

Për këtë arsye i sugjeroj komisionit përgjegjës ta riformulojë, duke mbajtur në konsideratë faktin se punësimi i më shumë se 1 personi me aftësi të kufizuar për 49 punëmarrës, konsiderohet si një e drejtë e pakushtëzuar dhe mund të mos ketë nevojë për dhënie leje apo për miratim nga Agjencia e Punësimit dhe e Aftësive.

Gjithashtu, sugjeroj që pika 5 të hiqet, pasi ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, nuk bën një ndarje të shkallës së aftësisë së kufizuar. Sipas kuptimit të dhënë në nenin 3 të këtij ligji, persona me aftësi të kufizuara janë individët që kanë dëmtime afatgjata fizike, mendore, intelektuale ose ndijore, dëmtime, të cilat në bashkëveprim me pengesat e ndryshme, përfshirë ato mjedisore dhe të qëndrimit, mund të pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe efikase të këtyre personave në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët. Pra, sugjeroj që pika 5 të hiqet nga dispozita.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zonja Hysi!

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, unë kam 2 çështje:

E para, është paragrafi i dytë i këtij neni. Parimi bazë që përcaktohet në paragrafin e parë, që çdo punëdhënës, i cili punëson më shumë se 49 punonjës, duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 50 punonjës të personelit të tij, bie poshtë me parashikimin e paragrafit të dytë, sepse ky paragraf i jep mundësi punëdhënësit të mos marrë një punonjës dhe ai në këtë rast duhet të paguajë 50% të pagës minimale. Kjo nuk është dispozitë nxitëse, se nuk është ky synimi. Synimi ynë është të mundësojmë për personat me aftësi të kufizuar të punësohen dhe në Kodin e Punës në vitin 2015 kemi bërë disa ndryshime për përshtatjen e mjediseve etj. Mund të ndodhë që për një arsye ose për një tjetër zyrat e ndërmjetësimit të mos ofrojnë kandidatura, por të paktën pagën minimale 100% duhet ta paguajnë, se përndryshe i bie që të gjithë më mirë të paguajnë 50-përqindëshin. Atëherë, mos e vini parashikimin detyrues të paragrafi i parë.

E dyta, lidhur me paragrafin e tretë dhe këtu pajtohem me propozimin e koleges Xhina. Ky paragraf thotë që punëdhënësit bëjnë kërkesë pranë strukturës përkatëse rajonale/vendore për të plotësuar vendet e punës me persona me aftësi të kufizuara.

Jo, një punëdhënës mund të gjejë vetë persona në treg, i interviston dhe mund t'ia bëjë kërkesë strukturës për të kërkuar ndihmë, kur ai e çmon të nevojshme për të marrë një listë të personave. Unë mendoj ta riformulojmë dhe të mos ta detyrojmë ta fusim biznesin apo institucionin në këto kalenda. Kuvendi i Shqipërisë e di detyrën që ka dhe nuk ka pse të marrë zyrën e punës. Nëse në konkurrim, nuk gjemë dot personat, atëherë mund t'i themi zyrës së punësimit të na japë listën e personave, që mund të jenë për këtë pozicion që kemi në Kuvend.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Hysi!

Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Natyrisht, ky nen ka shumë diskutime dhe unë jam deri diku dakord me zonjën Hysi. Fakti që qeveria i ka sjellë të formuluar kështu pikat 1 dhe 2, ka një arsye. Këtë arsye e tha edhe zëvendësministrja shumë drejtë. Në ligjin e mëparshëm të vitit 1995, raporti ishte 1 person me aftësi të kufizuara për 24 punonjës. Nuk ka ndodhur asnjëherë të zbatohet kjo. Pra, nuk ka asnjë të punësuar nga kategoria PAK në privat për çdo 24 punonjës. Tani kemi vënë raportin 1 person me aftësi të kufizuara për 49 punonjës. E kemi rritur pak numrin për ta stimuluar punëdhënësin privat.

Nga ana tjetër, pika 2, që është vendosur në këtë nen, vërtet nuk e stimulon, por i vë një lloj penaliteti. Punëdhënësi, i cili nuk punëson numrin e përcaktuar të personave me aftësi të kufizuara, sipas pikës 1, të këtij neni, derdh një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën e 50% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo muaj, për çdo person me aftësi të kufizuara që ai duhet të kishte punësuar, sipas këtij neni.

Natyrisht, punëdhënësit mund t'i dhimbset të paguajë 50% të pagës dhe mund të jetë më i interesuar për të punësuar një person të kësaj kategorie.

Të mos harrojmë edhe një gjë tjetër. Duhet vlerësuar shumë pika 6 e këtij neni, e cila është e jashtëzakonshme: “Punëdhënësit, publikë apo privatë, janë të detyruar të sigurojnë ruajtjen e vendit të punës për ata individë, të cilët, në kohën e punësimit nuk kanë qenë me aftësi të kufizuara, por kanë fituar aftësinë e kufizuar nga aksidentet në punë ose nga sëmundjet profesionale.” Kjo është një gjë shumë e mirë dhe duhet vënë në ligj dhe duhet zbatuar.

Po kur punëdhënësi thotë se e ka një punonjës me aftësi të plota, që doli me aftësi të kufizuara që po e mban përsëri në punë dhe nuk e realizon dot pikën 1 dhe pikën 2 të këtij neni? Pra, në të gjithë kontekstin e kësaj unë mendoj që bëjmë mirë që e vëmë në ligj, por në përgjithësi ka probleme për zbatimin në praktikë.

Unë jam kundër propozimit të zonjës Hysi, që thotë se sipas pikës 2 nuk ia ka vënë shumë detyrimin privatit për derdhjen e shumë prej 50% të pagës dhe duhet ta vërë 100%. Absolutisht, jo. Bizneset private punojnë dhe kontribuojnë në taksat vendore dhe të përgjithshme. Njëkohësisht, ai kontribuon edhe në bashkëpunim me zyrat rajonale të punësimit për të marrë njerëz, që duan t'i punësojnë dhe t'u thuash pse nuk ke marrë në punë persona të kategorisë PAK dhe për këtë duhet të paguash pagën 100%, mua më duket sikur po u vëmë një taksë të re. Unë nuk jam dakord që të rritet, por jam dakord që të mbetet kaq sa është, me idenë për ta stimuluar pak. Jam absolutisht kundër rritjes së saj në masën 100%.

Ulsi Manja – Faleminderit!

Urdhëroni, zoti Hyseni!

Alket Hyseni – Faleminderit, kryetar!

Duke gjetur të drejta shumë nga sugjerimet e koleges Hysi dhe të kolegut Fino, unë gjej me vend të ndaj me ju shqetësimin që tashmë duhet ta pranojmë që po hyjmë në regres për sa i takon mbrojtjes që synon shteti ynë për një kategori shumë vulnerabël, e cila jo se nuk ka dëshirë dhe vullnet, por nuk e realizon dot punësimin. Pse duhet të kalojmë ne nga 25 në 50, në kushtet kur numri i ndërmarrjeve në një pjesë të madhe të territorit të RSH-së me mbi 50 punonjës është shumë i vogël? I bie që në Konispol është zero mundësia për të punësuar kategorinë PAK, sepse nuk ka asnjë ndërmarrje me mbi 50 punonjës; në Finiq është zero mundësia për të punësuar kategorinë PAK, sepse nuk ka asnjë ndërmarrje me mbi 50 punonjës, ndërsa në Delvinë është 1 mundësia për të punësuar nga kategoria PAK; në Sarandë mund të jetë më pak se 5 (nuk e kam të saktë shifrën se sa është). Teorikisht po flas. Pra, ne po shkojmë në regres.

Unë mendoj se duke paraqitur shqetësimet të mund të kalojmë në një mesatare, në një kompromis që t'i kemi të kategorizuara. Edhe me numrin 25 që ishte edhe me këtë numër të vëmë 50% të pagës minimale si penalitet (në rast se nuk e zbaton) dhe numri 50 të bëhet me propozimin e zonjës Hysi me një penalitet më të lartë, sepse synimi është që t'i thuhet punëdhënësit që e ka detyrim për ta marrë në punë. Po nuk e bëmë me detyrim, nuk ka për ta marrë mundësia për të punësuar kategori PAK, sepse nuk ka asnjë ndërmarrje me mbi 50 punonjës. Ne nuk mund ta lëmë me çmimin moral të punëdhënësit. Këtë pjesë të legjislacionit shqiptar për këto kategori sociale, siç ka edhe shumë detyrime të tjera. Nuk është vetëm ky. Punëdhënësit nuk po ngarkohen me ndonjë detyrim antikushtetues. Kanë shumë detyrime të tjera. Një nga ata mund të jetë edhe ky.

Për të ndihmuar zona të caktuara, duhet ulur numri. Në të kundërt, po bëjmë një ligj vetëm për Tiranën dhe për Durrësin. Mos u nisni vetëm nga statistikat e përgjithshme në shkallë vendi. Ligji duhet të bazohet në statistikat lokale.

Unë kërkoj ta shtyjmë miratimin e ligjit që t'u japim kohë relatorëve që ta diskutojnë me ministrinë edhe këtë pikë. Mos ta miratojmë sot, që të mos nxitohemi. Të bëjmë një ligj që të na vlejë për njerëzit në kushte reale.

Unë mund t'ju jap një shembull. Kam një djalë të verbër, i cili ka përfunduar fakultetin. Ai është një djalë i shkëlqyer. Ai është në gjendje të përdorë celularin dhe unë nuk po gjej asnjë mundësi për ta punësuar në ndonjë vend. Ai mund të bëjë operatorin diku. Unë nuk po arrij ta punësoj atë në asnjë punë. Ai quhet Ermal Faja dhe është një djalë i shkëlqyer, superinteligjent. Ndoshta, mund të jetë më inteligjent edhe se një pjesë e anëtarëve të parlamentit, sidomos nga ajo pjesë që dorëzoi mandatet.

Si mund ta ndihmojmë ne këtë kategori, kur ne e rrisim numrin në 50? Unë nuk kam lënë pa trokitur në ndërmarrje, me synimin e 25-ës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Asnjë çast. Prandaj, kërkoj të jemi të kujdesshëm dhe duke diskutuar edhe me komisionin përgjegjës. Ju them të niseni nga bashkitë rurale, nga bashkitë e vogla, ku nuk ka biznese të mëdha dhe mos u nisni nga Tirana dhe nga Durrësi, ku janë përqendruar ndërmarrje të mëdha, që kanë punësuar qindra punëtorë dhe ku, patjetër, mund të aplikohet kjo normë!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Urdhëroni, zonja Sorensen!

Dajna Sorensen – Unë dua të sqaroj vetëm një element. Përveç kushtit që ndërmarrjet kanë aktualisht apo që do të kenë raportin 1-25 apo 1-50, që po diskutojmë, të gjitha ndërmarrjet kanë gjithashtu, mundësinë për të përfitur nga punësimi i subvencionuar. Ka aktualisht sot një VKM për punësimin e personave të kategorisë PAK, ku për një periudhë 24-mujore një person PAK mund të punësohet, i subvencionuar nga buxheti i shtetit. Me pak fjalë, edhe një bashki nuk i ka ndërmarrjet në madhësinë optimale, kjo nuk do të thotë që nuk mund të punësosh një person të tillë nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit. Pra, nuk i përjashton. Madje një element i rëndësishëm i këtij projektligji është, nëse ti automatikisht si biznes nuk e ke përmbushur kriterin që të cakton ligji, pra që një biznes duhet të punësojë një person me aftësi të kufizuara për çdo 50 punonjës të personelit të tij, ti nuk mund të përfitosh nga programet e nxitjes për punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Pra, nëse sot ke punësuar 100 punonjës sot, duhet të punësosh 2 persona me aftësi të kufizuara. Nëse do të marrësh persona PAK mbi këtë numër, mund të subvencionohesh nga buxheti i shtetit.

Megjithatë, dua të them vetëm një element: nëse unë do të kisha një biznes privat dhe do të merrja një person me aftësi të kufizuara, të cilit do t'i paguaja minimalisht një pagë minimale apo nuk do ta merrja në punë një person me aftësi të kufizuara dhe do të paguaja 50% të kësaj page, nëse pritshmëria e biznesit, produktiviteti i këtij individi do të jetë mbi pagën minimale, kjo do të jetë e vetmja mundësi që ata kanë për ta konsideruar dhe për ta marrë këtë person në punë. Pra deri diku, 100-përqindëshi ka kuptim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, jam me ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem!

Bashkim Fino – Unë jam që ky nen të mbetet siç është, sepse ne jemi shteti që duhet të kërkojmë kushte të njëjta edhe për personat me aftësi të kufizuara.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne sot, si shtet mbase nuk i kemi krijuar të gjitha kushtet për këtë kategori. Më thoni jo për Tiranën, por në çdo bashki të Shqipërisë a ka vende parkimi për personat me aftësi të kufizuara?

Minimalisht, në vende të ndryshme të botës ka vende posaçërisht për ta dhe ti nuk e vë dot makinën në hapësirën për ta, se po e vure, të vihet gjobë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam në përgjithësi diskutimin, nuk e kam për kryetarë të veçantë. E kam në kuptimin që shteti duhet të krijojë kushte për personat me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me privatin, për hipjen në autobus, në ashensor, nëpër në hotele, për punësimin etj.

E dyta, ne duhet të këmbëngulim fort që të gjitha institucionet shtetërore, këtu kam parasysh bashkitë, por edhe ndërmarrje të tjera, të zbatojnë nenin 21 të këtij projektligji. A i marrin ata këta njerëz në punë? Më pas t'i kërkojmë këto gjëra edhe te privati, sepse edhe ata janë humanë dhe duhet ta bëjnë një gjë të tillë. Ka nga ata që bëjnë edhe sponsorizime në këtë fushë. Zëvendësministrja u kënaq me propozimin e zonjës Hysi që ta bëjmë 100%, por unë mendoj se nuk duhet të improvizojmë këtu. Mendoj se 50% është shumë.

Neni 2, pika 2 e këtij nuk ...

Neni 21 thotë: “Punësimi i personave me aftësi të kufizuara”. Pra, flet për punësimin dhe jo penalitetet. Ti thua që do ta punësoj, por nëse nuk e punëson, unë do të ta jap këtë penalitet. Jo, kjo është për punësimin dhe jo penalitetet.

Unë mendoj që ta bëjmë një sy qorr dhe ta lëmë siç është, sepse nëse flasim siç është në realite, pika 2 duhet të hiqet fare.

Ulsi Manja – Zoti Fino, unë jam shumë dakord që qëllimi i këtij neni është punësimi i personave me aftësi të kufizuara. Po flasim për sektorin shtetëror, por edhe për sektorin privat.

Ju mund ta vini edhe 150%, por problemi është që nuk mund të penalizoni bizneset, sepse bizneset janë partnerët kryesorë të zhvillimit të ekonomisë; paguajnë taksa, zhvillojnë investimet e të tjera. Nuk është çështje dëshire. Qeveria e ofron 50%-in si penalitet në rast të mospunësimit. Mund ta bëjmë edhe 200%, por problemi është se nuk mund ta rëndojmë biznesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe për bashkitë jam dakord. Nuk mund të rëndohen bashkitë.

Kështu që, unë mendoj ta lëmë të hapur këtë nen ashtu siç lamë tre nenet e tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi - Në vazhdim të sugjerimit që ngriti kolegja Xhina për nenin 5, unë kam një qartësim. Një punëdhënës mund të punësojë një person me aftësi të kufizuara të rënda dhe të thella në vend të një personi me aftësi të kufizuara të lehta.

E para, kush do ta përcaktojë aftësinë e kufizuar të rëndë dhe të thellë?

E dyta, ky kriter duhet lidhur me paragrafin e parë të këtij neni. Pra, çdo punëdhënës që ka më shumë se 49 punonjës ka të drejtë ... Duhet të bëjmë një riformulim sipas kriterit të parashikuar në paragrafin e parë të këtij neni. Pra, duhet të bëjmë lidhjen e pikës 5 me pikën 1 të nenit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne jemi komision për dhënie mendimi dhe nuk e dimë se çfarë do të bëjë komisioni përgjegjës. Nëse komisioni përgjegjës do ta lërë, nga pikëpamja e teknikës legjislative dhe qartësisë së normës duhet të bëjë lidhjen e pikës 5 me paragrafin e parë të nenit 1.

E dyta, në pikën 6 thoni që punëdhënësit publikë janë të detyruar të sigurojnë ruajtjen e vendit të punës. Çfarë ndodh nëse punëdhënësi publik ose privat nuk e ruan? Do të ketë penalizime si në pikën 2, që do të paguajë 50% të pagës minimale, sepse edhe kjo ka pasoja, apo do ta lëmë të lirë? E kam pyetje dhe sugjerim për komisionin përgjegjës që ta shqyrtojë këtë çështje.

Ulsi Manja – Vazhdojmë me nenin 22.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Duhet të riformulohet.

Bashkim Fino – Relatorja propozoi që pika 5 duhet hequr. U bënë propozime nga zonja Hysi që 50%-i të bëhet 100%, ndërkohë që unë them të jetë siç e thotë qeveria.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord, edhe Hyseni.

Nuk u bënë propozime të tjera.

Jeni dakord ta heqim pikën 5?

Për pikën tjetër ka dy mendime, 50% ose 100%. E hedhim në votim dhe e kalojmë. Nuk kemi pse presim. Unë jam sipas variantit të qeverisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zëvendësministrja duhet të ketë parasysh që mbron një projektligj që ka kaluar në qeveri. Nuk mund të mbrojë një projektligj që e improvizon në moment. Ne mund të bëjmë propozime konkrete, kurse ajo është e detyruar të mbrojë nenin 21. Ajo mund të mos ketë vërejtje nëse ne e shtojmë tarifën 100%, por është e detyruar të mbrojë materialin e qeverisë.

Ulsi Manja – Po, zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Në këtë nen janë së paku katër probleme që duhet t'i zgjidhim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi rënë dakord edhe me relatoren që ka një tërësi problematikash për t'u ridiskutuar. E para, është numri 50 apo 25, e dyta është përqindja, e treta është çështja se kush e përcakton aftësinë e kufizuar (mos u shqetësoni se janë të kategorizuara, aftësi e pjesshme, e plotë, e shkallës më të rëndë), dhe e katërta është detyrimi i punëdhënësve publikë dhe privatë për të siguruar ruajtjen e vendit të punës nëse do bëhet me sanksione apo jo. Do ta lidhim më vonë me nenin 23. Le t'i lëmë kohë relatores dhe ministrisë ta diskutojnë.

Ulsi Manja – Fjalën e ka relatorja.

Elena Xhina – Jam dakord me sugjerimet e kolegëve për sa kohë u ngritën probleme, por, gjithashtu, u tërheq vëmendjen që të jenë më të vëmendshëm kur unë bëj sugjerime, sepse pikërisht për ndarjen e kategorive fola, që janë dhe të mos jenë te pika 5. Për sa u përket të tjerave, nëse keni propozime konkrete i bëni sot, sepse duhet t'ia kalojmë komisionit përgjegjës për t'i vlerësuar më tepër. Ndaj, ftoj gjithsecilin prej jush që ka propozime konkrete t'i paraqesë ato.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Xhina!

Në fakt, jemi në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen në Komisionin e Ligjeve dhe jo në grupin e punës për hartimin e projektligjit. Është mundësia që po ju jap meqenëse lamë të hapur tre nene, sepse do ta kisha votuar tani nenin 21.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ligji është produkt i iniciativës ligjore të Këshillit të Ministrave dhe jo produkt apo iniciativë deputetësh.

Deputetët bëjnë një propozim konkret për një nen të caktuar dhe hidhet në votim. Kjo është procedura. Unë po e lë të hapur nenin 21 për të reflektuar në një moment më të qetë sugjerimet që bënë kolegët, por asnjë nen tjetër nuk do të ngelet më i hapur pas kalimit të nenit 21.

Ky projektligj ka dy vjet që po diskutohet me grupet e interesit dhe faktorët që kanë ndikim në tregun e punës.

Neni 22. Fondi Social i Punësimit.

Në pikën 4 të nenit 22 duhet të përcaktohet në mënyrë eksplicite se burimet financiare të Fondit Social të Punësimit nuk mund të përdoren për qëllime të tjera veç atyre të përcaktuara në këtë pikë.

Është dakord relatorja me këtë?

Elena Xhina – Po.

Ulsi Manja – Dakord. Hedhim në votim nenin 22.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Nëse ju keni mundësi të tjera, duhet vendosur në ligj apo duhet thënë “edhe me ndonjë akt tjetër”? Mund të ketë donacione të ndryshme. Fondin e krijon nga kontributet e derdhura për llogari të fondit, nga të ardhurat e krijuara nga burime të ligjshme, përfshirë financime, grante dhe marrëveshje të Këshillit të Ministrave, si dhe nga buxheti i shtetit.

Ulsi Manja – Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Riformulimi që bëri zonja Xhina përmbledh edhe pikën 5. Në pikën 5 të këtij projektligji thuhet që punëdhënësit kanë të drejtë të kërkojnë subvencionim nga strukturat përkatëse rajonale vendore për rikonstrukcion dhe përshtatjen e vendeve të punës. Po punëdhënësi ka të drejtë të bëjë programe që lidhen me nenin 11, pika 2 e këtij ligji? Ka një kakofoni. Nga një anë thuhet që Fondi Social i Punësimit, sipas pikës 4, përdoret për programe që synojnë punësim, vetëpunësim, rehabilitim, e të tjera, nëse i kthehemi nenit 11, pika 2 po të këtij ligji, thuhet që programet e nxitjes së punësimit përfshijnë angazhimin e punëdhënësve, ku hyn edhe rregullimi i vendit të punës dhe përshtatje të arsyeshme, kurse te pika 5, rregullimin ose rikonstrukcionin e vendeve të punës për t’i bërë të përshtatshme e evidentonin në mënyrë specifike. Pse jo vetëm këto dhe jo aspekte të tjera?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Fino!

Zonja Sorensen, ka ndonjë përgjigje për këtë pyetje të koleges Hysi?

Dajna Sorensen – Nëse bëhet fjalë për një biznes që ka 25 persona të punësuar dhe është i gatshëm të marrë një person me aftësi të kufizuara, ky mundëson që ai person mund të përfitojë nga përshtatja e arsyeshme për ta punësuar një person me aftësi të kufizuara.

Ulsi Manja – Shumë faleminderit!

Hedhim në votim nenin 22.

Pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

Kreu i tetë. Sanksionet.

Neni 23.

Elena Xhina – Në nenin 23 kemi një riformulim të dispozitës së sanksioneve, e cila është bërë në përputhje me ligjin “Për Inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”. Sugjerojmë që procedura e shqyrtimit të ankimit të bëhet në përputhje po me këtë ligj pasi nuk është parashikuar ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Me ligjin “Për Inspektimin e Punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”.

Vasilika Hysi – Zoti kryetar, në dijeninë time shërbimi i inspektorateve është në kuadër të ristrukturimit. Përfaqësuesja e ministrisë, zonja Sorensen, mund ta konfirmojë këtë. Për të shmangur rikthimin dhe rishikimin e këtij ligji sugjeroj të themi: “punëdhënësi që nuk derdh kontribute, sipas pikës 2 të nenit 21 të këtij ligji, dënohet për kundërvajtje administrative nga inspektorati përgjegjës sipas legjislacionit në fuqi për inspektimet e punës.

Ulsi Manja – Dakord.

Vasilika Hysi – Në dijeninë time, ka një reformë të thellë, të nisur prej disa vjetësh dhe mund të kemi inspektorate, të cilat do të bëhen një, apo jo, zonja Sorensen, sepse ju jeni përfaqësuese e qeverisë dhe e dini më mirë?

Dajna Sorensen – Jemi dakord.

Ulsi Manja – Kush është dakord me nenin 23, me sugjerimin e bërë nga relatorja dhe zonja Hysi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te kreu 9, “Dispozitat përfundimtare”.

Vazhdojmë me nenin 24, “Shfuqizimet”.

Nuk ka sugjerime për nenin 24. Kush është pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet neni 24.

Kalojmë të neni 25, “Dispozitë kalimtare”.

Elena Xhina – Për nenin 25 sugjerohet që komisioni përgjegjës të parashikojë çështjet për afatin e ngritjes së institucioneve të reja që do të parashikojë ky ligj, kalimin e të gjitha të drejtave, detyrimeve, buxhetit, si dhe dokumentacionit administrativ dhe financiar, që është aktual, tek institucionet përgjegjëse, që ne, faktikisht, i kemi lënë hapur, por do të përcaktohet më pas.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin? Zonja Spahiu?

Keni sugjerim?

Klodjana Spahiu – Ju lutem, kur të përfundoni ...

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 25, “Dispozitë kalimtare”, me sugjerimet e relatores? Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 26, “Miratimi i akteve nënligjore”.

Bashkim Fino – Kam një vërejtje këtu, zoti kryetar!

Ulsi Manja – Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Vërejtja për nenin 26 është se përgjithësisht ne i sjellim ligjet këtu. Përfaqësuesit e ministrive, kur vijnë të bisedojmë për relacione, na tregojnë se kanë punuar kaq kohë, kanë diskutuar me grupin e interesit e të tjera. Pra, na japin një pasqyrë, ku na thonë se kanë kohë që e kanë përgatitur projektligjin, kanë pyetur grupin e interesit dhe pas kaq kohësh, pasi e kalojnë edhe në qeveri, e sjellin në parlament. Po vërej me çudinë më të madhe, që kur erdhëm te neni i fundit, te aktet nënligjore, vendimi nga Këshilli i Ministrave apo ministri përgjegjës, kërkuan një afat super të madh deri në 12 muaj. Një grup pune i ngritur nga ministria, që ka përgatitur projektligjin, siç e tha zëvendësministrja, me një aktivitet shumë të madh takimesh, që në vitin 2014, në mos gaboj, si nuk i ka bërë gati aktet nënligjore në funksion të këtij projektligji, që ne do ta bëjmë ligj?!

Mendoj që këta të mos tallen me ne, por ky nen të korrigjohet urgjent dhe Këshilli i Ministrave... Unë pretendoj që grupi i punës ka punuar edhe aktet nënligjore dhe i ka të cilësuar: pika 5, pika 11, pika 4, pika 12, pika 6, pika 14, pika 20, ndaj t’i bëjnë jo më vonë se 3 muaj dhe natyrisht që ministri, brenda 3-4 muajve të nxjerrë edhe aktet e tjera nënligjore. Çfarë kuptimi ka që i lihet 1 vit ministrit për të nxjerrë aktet nënligjore dhe qeverisë i lihet 6 ...

Ulsi Manja – E kemi të lehtë këtë, zoti Fino.

Vasilika Hysi – Ligji bëhet eficient në qershor të vitit ...

Bashkim Fino – Çfarë rëndësie ka? Në qershor, që bëhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Unë e kam diskutim parimor këtë, zoti kryetar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk je dakord me mua? Dakord.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ulsi Manja – Unë jam dakord që pika 2 e nenit 26, “12 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit”, Ministria do kohë për të bërë aktet nënligjore, është që të zgjasë ligji 4 vjet, 2 vjet faza e konsultimit ...

Genta Prodan – Ka akte që duhet të dalë Këshilli i Ministrave një herë e më pas ...

Ulsi Manja – Mund të harmonizojmë pikën 1 me pikën 2.

Zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Shqetësimi i zotit Fino është i drejtë, por mos harroni që me nenin 21, pika 2, ne parashikojmë një detyrim financiar për punëdhënësit publikë dhe privatë. Pra, ka të drejtë biznesi, por buxheti i institucioneve për vitin 2019 është i matuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Më fal, sepse flitet për gjobën, për 50% që duhet mbajtur. Duhet të jemi pak të kujdesshëm, sepse biznesi duhet ta dijë kohë më parë se cilat janë masat që mund ta rëndojnë nga pikëpamja financiare. Pra, zoti Fino, pika 2 e nenit 26 ka të bëjë me zbatimin e pikës 2 të nenit 21, që thotë se nëse punëdhënësi nuk punëson, ka 50% të detyrimit. Pra, duhet të jemi pak të kujdesshëm, sepse nuk mund të ndërrojmë rregullat e lojës në mes të vitit, edhe kur kanë efekte financiare. Ju jeni një ndër ata që e keni luftuar fort këtë parim, ndaj duhet të jeni pak të kujdesshëm.

Ulsi Maja – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Të lutem, po ngre shumë çështje.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Dakord. Siguria juridike, por kjo ka të bëjë me pikën 2 të nenit.

Ministri do të ngrejë aktet nënligjore dhe do të njoftojë të gjitha zyrat përkatëse që të flasin me të gjitha bizneset. Por nuk mund ta lësh 1 vit, që e bën ligjin sot dhe hyn në fuqi në vitin 2021, kur të kemi mbaruar mandatin.

Ulsi Manja – Ju lutem, zoti Shameti!

Neni 26, relatorja.

Nuk ka sugjerime për nenin 26.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk ka sugjerime.

Elena Xhixha – Sugjerimi im do të ishte, por duhet marrë edhe mendimi i ministrisë, që ta bëjmë 3 muaj te dispozita e parë dhe 6 muaj tek e dyta.

Vasilika Hysi – Janë financa, janë ...

Ulsi Manja – Ju lutem, nëse do t'i shkojmë logjikës financiare që sugjeroi kolegja Hysi, nëse është kjo arsyeja që ministria e ka propozuar 6 me 12, unë dua një përgjigje.

Kjo është arsyeja që ju e keni bërë 6 me 12?

Dua të di cila ka qenë logjika që ju keni propozuar 6 muaj për Këshillin e Ministrave dhe 12 muaj për ministrinë përgjegjëse?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ju lutem, zoti Fino!

Genta Prodani – Janë caktuar 6 muaj për të gjitha vendimet e Këshillit të Ministrave që do të dalin në zbatim të këtij ligji, duke përfshirë edhe krijimin e fondit të punësimit e të tjera, kurse për 12 muaj është lënë udhëzimi i ministrit, i cili duhet të dalë pasi të krijohet fondi se si do të mblidhen procedurat.

Bashkim Fino – Duhet 6 muaj të tjera? 6 muaj i mori qeveria. Pasi të dalë vendimi i qeverisë, thua ti, të rrijë 6 muaj të tjera ministri, të shkojnë 12 muaj dhe të bëjë një akt...

Pse, ministri e bën udhëzimin, apo e bëni ju, që punoni atje?

Genta Prodani – Mendojmë se krijimi i fondit do të kërkojë, të paktën, një periudhë 6-mujore.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk është aq e thjeshtë.

Ulsi Maja – Të lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Po pse nxelesh?

Dakord, merre fjalën!

Bashkim Fino – Jam kundër këtij neni. Do të votoj kundër.

Ulsi Maja – Dakord.

(Diskutime pa mikrofon.)

Relatorja, ju lutem!

Varianti i qeverisë është 6 me 12 muaj. Nuk ke propozim konkret ...

Elena Xhixha – Pikërisht, zoti kryetar, thashë se duhet marrë mendimi i ministrisë.

Ulsi Manja – Ministria është për 6 me 12.

Elena Xhixha – Dakord, hedhim në votim 6 me 12.

Ulsi Manja – Zoti Fino, të hedhim në votim variantin e qeverisë?

(Diskutime pa mikrofon.)

Ju lutem!

Hedhim në votim neni 26, sipas variantit të qeverisë.

Ne do të votojmë si komision për dhënie mendimi. Nëse komisioni përgjegjës do ta çmojë se mund të bëhen më parë këto akte, le ta bëjë. Ne do të hedhim në votim variantin e qeverisë.

Kush është pro? Kundër? 1 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet!

Zoti Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Bashkim Fino – Le ta dëgjojnë kolegët e mi.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ti edhe mund të mos e dëgjosh. E kam për qejfin tim, për procesverbalin. Ju edhe mund të largoheni.

Votova kundër këtij projektaktit të fundit, sepse është në sinkron të plotë me hipokrizinë që paraqet zëvendësministria ose qeveria, kur vijnë dhe na thonë se kanë disa vjet që kanë ngritur grupe pune, kanë punuar e të tjera. Të punosh për një projektligj për disa kohë dhe të vish t'i kërkosh këtij parlamenti, pasi ne e miratojmë, se do kohë edhe 1 vit tjetër për të bërë aktet nënligjore, për të bërë një udhëzim dhe disa vendime qeverie, më duket shumë absurde dhe është shumë e turpshme që ne kërkojmë të hyjë në fuqi ky ligj në vitin 2020. Pra, do të hyjë në fuqi në mars ose në prill të vitit 2020, sipas nenit që sapo votuat ju, ndaj votova kundër.

Ulsi Manja – Kalojmë te neni 27, “Hyryra në fuqi”.

Pro? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju lutem, sot nuk do të votohet projektligji në tërësi, sepse kemi lënë të hapura nenet 14, 15 dhe 16, që i përkasin kreut 5 dhe nenin 21, që i përket kreut 7. Të mbyllen këto 4 nene dhe nesër do të kalojmë projektligjin edhe në tërësi.

Po ia jap fjalën zonjës Spahiu, si kryetare e komisionit përgjegjës.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë u bëra pjesë e diskutimit që po bëni ju meqenëse ne sapo mbaruam një seancë dëgjimore me grupet e interesit. Meqenëse ju i keni lënë të hapura 2-3 nene, ato kanë sjellë një propozim, që mua më duket me vlerë ta diskutojmë bashkë dhe nëse mundet, të bëjmë një

riformulim, edhe për bashkëpunim, sepse ne kemi mungesë të këshilltarit ligjor dhe, të paktën, për këtë projektligj, do të na duhet një bashkëpunim intensiv me ju, për të sjellë diçka që duhet.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Patjetër, me shkresë zyrtare.

Në seancën dëgjimore dhe në të gjitha propozimet që kanë ardhur me shkrim në komisionin përgjegjës është bërë një propozim nga Shoqata e Invalidëve të Punës. Janë rreth 29 mijë invalidë të punës, të cilët, nga komisioni që bën vlerësimin e aftësisë për punë, janë të përcaktuar si të aftë për punë.

Gjithashtu, në mënyrë të vazhdueshme, komisioni që bën vlerësimin për sëmundshmërinë, përcakton nëse një person i sëmurë me sëmundje kronike ose akute është ose jo i aftë për punë. Mund të dalë i aftë për punë të lehtë, i aftë për 6 ose 8 orë punë të lehtë, ose i aftë për punë. Në momentin që ai konsiderohet i shëruar nga sëmundja, mbetet i lirë në tregun e punës, por është shumë e vështirë që personat me një sëmundje të jenë aktiv në tregun e punës ose të punësohen. Kërkesa e tyre është që në nenin 21 të përfshihen edhe invalidët e punës, të cilët janë përcaktuar nga ky komision si të aftë për punë ose si të aftë për punë të lehtë. Përveç kësaj, të përfshihen edhe ata që dalin si të aftë për punë të lehtë nga Komisioni i Invaliditetit. Ata e kanë të përcaktuar edhe me numër, siç është e përcaktuar edhe për personat me aftësi të kufizuar, sepse, në bazë të ligjit të aksesueshmërisë, që ne kemi vite që e kemi miratuar, bëhet kategorizim për personat me aftësi të kufizuar dhe do të jetë një komision multidisiplinor që do të bëjë këtë kategorizim. Jam shumë dakord me pikën 5 të nenit për përfshirjen në punë të personave me aftësi të kufizuar të rëndë. Një person me aftësi të kufizuar të rëndë nuk mund të përfshihet në tregun e punës dhe nuk kemi arsye pse ta fusim, e para.

E dyta, ne duhet të mendojmë pak më gjerë për nenin 21, nëse edhe ju jeni dakord, se si do ta riformulojmë për sa i përket përfshirjes së individëve që janë të papunë, por që është e vështirë të përkrahen nga punëdhënësit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Spahiu!

Duke qenë se nuk po e votojmë në tërësi projektligjin, por kemi lënë të hapura 4 nene, këtë e kam për relatoren dhe këshilltarët, cila është mundësia që Komisioni i Ligjeve të përfshihet në nenet 14, 15, 16 dhe 21 në këtë fazë të diskutimit të projektligjit në komision? Pjesa tjetër ose sugjerime që kanë të bëjnë me nene të tjera, janë votuar në komision tashmë dhe komisioni ynë nuk mund të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ndërkohë, për sa i përket shqetësimit që ngritët për mungesën e këshilltarit ligjor në komisionin përgjegjës, komisioni që ju drejtoni, këshilltarët e Komisionit të Ligjeve do të jenë

në dispozicion të komisionit tuaj për shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji si komision përgjegjës. Pasi ne të mbyllim projektligjin këtu në tërësi, me reflektimet përkatëse për neni 21, që e kemi lënë hapur, të formulohet edhe raporti përkatës për komisionin tuaj, këshilltarët tanë, që janë marrë me këtë projektligj, do të jenë edhe në Komisionin e Veprimtarive Prodhuese për t'i adresuar si duhet edhe shqetësimet që ju si komision përgjegjës do të bini dakord për t'i reflektuar së bashku me Ministrinë Përgjegjëse të Financave.

Këtu dua ta mbyll mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Faleminderit, për debatin konstruktiv, në mungesë të opozitës!

Është thënë më shumë se një herë që ky komision ka kapacitetet e duhura për ta bërë edhe opozitën, por ka rëndësi që produkti, që do të votojmë në komision dhe në seancë, ligji përkatës, të jetë një produkt që do t'u shërbejë qytetarëve shqiptarë.

Faleminderit, zonja Sorensen, së bashku me stafin!

Faleminderit, të dashur kolegë!

Ditë të mbarë! Mbledhja e radhës do të jetë nesër!

Rendi i ditës dhe ora do t'ju njoftohet nga sekretarja e komisionit.

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

